

CALL YOUR COUNTRY

FOL ME VENDIN TËND
DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.

WIND
Informazione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.5 - MAGGIO/MAJ 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

CALL YOUR COUNTRY

FOL ME VENDIN TËND
DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.

WIND
Informazione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

QUARTA PARETE

teatri i shqiptarëve në itali

Grupi teatral i
ngritur nga
Dardana
Bërdyna dhe
Albert Dedja
është
e vetmja përvojë
sipërmarrjeje
teatrale të
artistëve shqip-
tarë në Itali



FLUKSET STINORE Ja si mund të përfitoni

Nga 15 prilli po paraqiten on-
line kërkesat për sjelljen në
Itali për punësim stinor të
qytetarëve të huaj. Deri më
20 prill, 3.081 kërkesa janë
paraqitur për shqiptarë.



“Unë, polic kufiri, e di ç’do të thotë të jesh emigrant”

Intervistë me Nicola
Montanon, ish polic i kufirit në
portin e Barit, që mes përvo-
jave të tij të shumta ka përjetu-
ar edhe mbërritjen e anijes
"Vlora" në Bari në gusht 1991.
Përjetimet i ka hedhur në një
libër, "Ladri di stelle" i sapodale
në shtyp ku tregon histori
klandestinësh, ngjarje të
dhimbshme njerezore që
përbejnë përditshmerinë
e një polici kufiri.



WESTERN
UNION
MONEY TRANSFER

www.stranieriinitalia.it
il portale dell'immigrazione



Ministero per le Pari Opportunità

UNAR
Ufficio Nazionale
Antidiscriminazioni Razziali

Viktimë e racizmit?

Telefono falas NË NUMRIN E GJELBËR
800.90.10.10

Hyrja në Itali për motive pune stinore, ashtu si edhe për punë të varur, disiplinohet nga dekreti i flukseve me të cilin qeveria përcakton çdo vit numrin maksimal të të huajve që mund të hyjnë në Itali.

Dekreti i flukseve për punë stinore, përcakton pikërisht numrin e të huajve që mund të hyjnë në Itali për të lidhur një kontratë pune me karakter stinor me një shtetas apo një ndërmarrje.

Sektori stinor dhe kohëzgjatja e kontratës

Punë stinore quhet ajo që kryhet për një periudhë të caktuar vjetore, ekskluzivisht në sektorët e bujqësisë dhe të hoteleve dhe restoranteve.

Nulla-osta për punë stinore është e vlefshme për minimumi 20 ditë dhe maksimumi 9 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës, dhe lëshohet nga Sporteli Unik për kohëzgjatje të barabartë me atë të punës stinore për të cilën kërkohet.

Në këto hark kohor është e mundur të ndërrohet punëdhënës, mjaft që puna të mbetet me stinore.

Procedura

Punëdhënësi, italian apo i huaj me qëndrim të rregullt në Itali, ose shoqatat e kategorive të interesuara të punësojnë shtetas jokomunitarë rezidentë jashtë Italisë mund t'i paraqesin një kërkesë për autorizim pune Sportelit Unik për Imigracionin të njëres prej provincave të mëposhtme: ku ka rezidencën punëdhënësi, ku ka selinë ligjore ndërmarrja ose ku do të kryhet puna.

Kërkesat për nulla-osta stinore për vitin 2009 paraqiten (nga ora 8.00 e 15 prillit 2009) deri në orën 24 të 31 dhjetorit 2009) vetëm on-line duke u lidhur me faqet internet të ministrisë së Brendshme (www.interno.it).

Procedura e ndjekur për lëshimin e autorizimeve për punën stinore është e njëjtë me atë të parashikuar për punën e varur, por shumë më e shpejtë në kohë (duhet të lëshohen brenda 20 ditëve në vend të 40 ditëve të parashikuara për punën e varur) dhe e thjeshtuar në verifikimet e brendshme (nuk parashikohet kontrolli i Qendrës për Punësimin për të

SI PARAQITET KËRKESA ON-LINE

1) REGJISTRIMI

Punëdhënësi duhet të lidhet me ueb-site-n e ministrisë së brendshme www.interno.it, të futet në zonën e rezervuar flukseve stinore 2009 dhe të regjistrohet, duke dhënë emër, mbiemër, ditëlindje, një adresë poste elektronike (e-mail) dhe një fjalëkalim. Më pas do të marrë në postën e tij një e-mail me udhëzimet për konfirmimin e regjistrimit dhe aktivizimin si përdorues (utente).

2) KRIJIMI I FORMULARËVE

Duke futur e-mail dhe fjalëkalimin, punëdhënësi i regjistruar mund të futet në zonën e rezervuar formularëve dhe të krijojë të posaçmit për kërkesat e punësimit. Për çdo formular duhet të fusë vetëm të dhënat e veta dhe ato të punonjësit stinor që kërkon të sjellë në Itali; përpilimi i mirëfilltë i formularëve do të bëhet në një moment të dytë.

3) PROGRAMI SUI

Në këtë pikë është e domosdoshme që punëdhënësi të shkarkojë dhe të instalojë në kompjuterin e tij programin Sportello Unico Immigrazione (SUI). Në këtë faqe gjeni lidhjet për të shkarkuar SUI për Eindoës, Linux e Os dhe manualin e udhëzimeve.

4) MARRJA E FORMULARËVE

Punëdhënësi duhet të vërë në funksionim programin SUI, të sigurohet që është i lidhur në internet dhe të shtypë butonin "importa i moduli elettronici nel programma". Duhet të fusë sërish e-mail dhe fjalëkalimin, e menjëherë formularët e aktivizuar fillimisht në ee.interno.it do të shkarkohen në kompjuterin e tij.

5) PËRPILIMI I KËRKESËS

Në këtë fazë punëdhënësi nuk duhet të jetë i lidhur në internet. Nga faqja kryesore e programit SUI, duhet të shtypë mbi butonin "visualizza domande da compilare" dhe të procedojë me mbushjen e të gjitha fushave të kërkesës (lloji i kontratës, ku do të strehohet punonjësi, karakteristikat e ndërmarrjes etj.) dhe më pas të shpëtojë (salva) kërkesën në pritje të çastit të duhur për ta nisur.

6) NISJA E KËRKESËS

Punëdhënësi duhet të lidhet në internet dhe të vërë në funksionim programin SUI. Të shtypë mbi butonin "visualizza domande da inviare" dhe të nisë kërkesat e punësimit për punonjësit stinorë. Pikërisht ky veprim mund të bëhet vetëm nga ora 8.00 e ditës së mërkurë 15 prill 2009.

”
Punonjësi stinor, nëse kthehet në atdhe me përfundimin e kohëzgjatjes së lejeqëndrimit, fiton të drejtën e përparësisë, ndaj të gjithë bashkatdhetarëve të tij që nuk kanë hyrë ndonjëherë në Itali për punë stinore, për të rihyrë sërish në vitin pasardhës për punë stinore. I huaji që hyn në Itali për punë stinore për të dytin vit rresht, mund të konvertojë lejen e qëndrimit për punë stinore në leje qëndrimi për punë jostinore, por vetëm në brendësi të kuotave të parashikuara në dekretin e flukseve

parë nëse ka në Itali punonjës të tjerë të gatshëm për të njëjtin vend pune).

Pasi merr kërkesën, Sporteli Unik ia përcjell atë Kuesturës (që verifikon mungesën e motiveve penguese për lëshimin e autorizimit) dhe Drejtorisë provinciale të punës (që verifikon kapacitetin ekonomik të punëdhënësit).

Pasi merr përgjigje pozitive nga Kuestura dhe Drejtoria e Punës, Sporteli Unik thërret punëdhënësin për lëshimin e nulla-ostës dhe për nënshkrimin e kontratës së qëndrimit dhe ia përcjell telematikisht nulla-ostën përfaqësisë diplomatike italiane të vendit ku ndodhet punonjësi.

Pasi tërheq nulla-ostën, punëdhënësi duhet t'ia nisë (në origjinal, jo fotokopje) punonjësit që duhet të paraqitet me pasaportë në përfaqësinë diplomatike italiane për të kërkuar vizën e hyrjes në Itali.

Brenda 8 ditëve nga ardhja në Itali, punonjësi i huaj duhet të shkojë pranë Sportelit Unik për të nënshkruar kontratën e qëndrimit dhe duhet t'ia nisë Kuesturës kompetente, me kom-

KA NISUR PARAQITJA E KËRKESAVE PËR 90.000 VETË

FLUKSET STINORE

Nga 15 prilli po paraqiten on-line kërkesat për sjelljen në Itali për punësim stinor të qytetarëve të huaj. Deri më 20 prill, 3.081 janë paraqitur



Kërkesat online nga 15 prilli

Pas disa muajsh pritjeje, më në fund mbërriti edhe dekreti i flukseve 2009 për punonjësit stinorë jokomunitarë, për bujqësinë dhe turizmin. Më 20 mars kryeministri italian nënshkroi tekstin që autorizon 80 mijë hyrje të reja punonjësish stinorë dhe më 15 prill filloi paraqitja e kërkesave on-line.

Deri tani paraqitja e kërkesave on-line nuk ka hasur probleme të veçanta. Sipas

ministrisë së Brendshme numri i kërkesave të paraqitura deri më 20 prill është 28.516 dhe me kalimin e ditëve vihet re një rënie e numrit të tyre. Në fakt vetëm dy ditët e para kërkesat e paraqitura ishin 22.208. Më të shumta janë nisur nga qytete të vogla si Latina, Ragusa, Verona, Cuneo, Ravenna ku me sa duket kërkesat për punonjës stinorë të ndërmarrjeve bujqësore apo të hoteleve dhe restoranteve janë të larta. Ndërsa përsa u përket kombësisë së punonjësve të thirrur kërkesat më të larta janë për indianë, bangladeshas, marokenë, shqiptarë e moldavë. Deri më 20 prill numri i kërkesave të paraqitura për punonjës shqiptarë është 3.081.

Ndryshe nga çfarë ndodh me flukset e jostinorëve kur numri i kuotave të vëna në dispozicion me dekretet kapërcehet nga numri i kërkesave të paraqitur brenda pak minutave, kuotat për punonjësit jostinorë janë të mjaftueshme dhe nuk është e nevojshme që kërkesa të paraqitet një çast e më parë. Kështu kush dëshiron të sjellë një të huaj për ta punësuar ka ende kohë për të paraqitur kërkesë për një kuotë të flukseve 2009 për punonjësit stinorë.

Sfida e administratës është t'i sjellë sa më shpejt këta punonjës. Dekretet u shpall vonë e nëse nulla-ostat vonojnë rrezikohet që, veçanërisht në bujqësi, punonjësit të sillen kur nuk nevojiten më. Për këtë qëllim zyrtarët që shqyrtojnë kërkesat u është dhënë mundësia të shohin, falë sistemit informatik, cilat janë më urgjentet e t'u japin përparësi.

Keti Blçoku



ja si mund të përfitoni

për shqiptarë. Kush dëshiron të sjellë një të huaj për punë stinore, të paraqesë kërkesën, ka shumë shanse t'ia dalë mbanë

pletin postar të formularëve, kërkesën për leje qëndrimi për punë stinore.

Leja e qëndrimit

Me lejen e qëndrimit për punë stinore mund të kryhet vetëm kjo lloj pune, pra nuk mund të kryhet punë e varur jostinore apo e pavarur.

Me të mbaruar periudha e autorizuar për punë stinore, shtetasi i huaj duhet të kthehet në atdhe. Lejeqëndrimi për punë stinore nuk mund të përtërihet, përtej kufijve të përcaktuar me ligj, dhe nuk mund të konvertohet në lejeqëndrim për punë të varur.

E drejta e përparësisë për vitin pasardhës

Punonjësi stinor, nëse ka respektuar kushtin e kthimit në atdhe me përfundimin e kohëzgjatjes së lejeqëndrimit, fi-

ton të drejtën e përparësisë, ndaj të gjithë bashkatdhetarëve të tij që nuk kanë hyrë ndonjëherë në Itali për punë stinore, për të rihyrë sërish në vitin pasardhës për punë stinore.

Konvertimi i lejes së qëndrimit

I huaji që hyn në Itali për punë stinore për të dytin vit rresht, mund të konvertojë lejen e qëndrimit për punë stinore në leje qëndrimi për punë të varur jostinore, por vetëm në brendësi të kuotave të parashikuara në dekretin e flukseve.

Kërkesa për konvertimin mund të paraqitet drejtpërdrejt nga punëdhënësi përmes procedurës telematike, vetëm pasi të jetë botuar në Gazetën Zyrtare dekreti i flukseve për punë të varur.

Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it

Ligji në fuqi parashikon mundësinë për shtetasin me qëndrim të rregullt në Itali të ribashkohet me familjarin e tij jokomunitar të dëbuar më parë dhe të regjistruar në SIS (Sistemi Informativ Shengen) vetëm në rast se familjari nuk konsiderohet subjekt i rrezikshëm për rendin publik

Bashkimi familjar me një të afërm

TË DËBUAR

dhe sigurinë kombëtare.

Në të shkuarën fakti që familjari ish dëbuar njëherë sillte automatikisht hedhjen poshtë të kërkesës për bashkim familjar dhe mohimin e vizës së hyrjes, me përjashtim të rasteve të heqjes së masës së dëbimit si pasojë e autorizimit të posaçëm për të rihyrë në Itali (përpara mbushjes periudhës kohore të parashikuar nga ligji) të lëshuar nga Ministria e Brendshme në raste shumë të rralla e të jashtëzakonshme.

Dekreti legjislativ nr. 5 i 8 janarit 2007, me të cilin Italia bën të vetën Direktivën europiane 2003/86/CE lidhur me bashkimet familjare, duke modifikuar nenet 4, 5, 13 të Tekstit Unik për imigracionin, parashikoi që i huaji për të cilin është kërkuar bashkimi familjar nuk pranohet në Itali vetëm nëse është vërtetuar që ai përbën kërcënim konkret dhe aktual për rendin publikose për sigurinë e shtetit.

Kështu, nëse sot kërkohet bashkimi familjar me një të afërm që është ndëshkuar me masën e dëbimit, autorizimi nuk do të jepet vetëm në rast se, sipas Kuesturës, ky përbën rrezik konkret dhe aktual për rendin publik dhe sigurinë e shtetit.

Nëse një pjesëtar i familjes suaj apo i afërm është ndëshkuar me masën e dëbimit (espulsione), ai mund të rihyrë nëpër Itali nëpërmjet procedurës së bashkimit familjar. Autorizimi nuk do të jepet vetëm në rast se, sipas Kuesturës, personi përbën rrezik konkret dhe aktual për rendin publik dhe sigurinë e shtetit.

JA PROCEDURA QË DUHET NDJEKUR



Pasi paraqitet kërkesa - përmes procedurës telematike - për bashkim familjar me një të afërm të sinjalizuar më parë në SIS, Sporteli Unik i përcjell kërkesën Kuesturës. Kjo e fundit verifikon nëse i huaji për të cilin është paraqitur kërkesa për bashkim nuk përbën kërcënim konkret dhe aktual për rendin publik dhe sigurinë e shtetit. Dhe në këtë rast jep një mendim të favorshëm të përkohshëm. Sporteli Unik sapo merr mendimin e favorshëm të Kuesturës, i dërgon kërkuesit një shënim, apo më mirë, një letër me të cilën lajmëron kërkuesin e bashkimit familjar që t'i komunikojë familjarit që kërkon të sjellë të shkojë pranë përfaqësisë diplomatike italiane për të legalizuar dokumentet që dëshmojnë lidhjen familjare.

Familjari paraqitet në ambasadën italiane me shënimin e Sportelit Unik dhe certifikatat që dëshmojnë lidhjen familjare. Ambasada italiane, pasi verifikon lidhjen familjare të kërkuar me ligj, duhet t'i legalizojë dokumentet përkatëse (në rast kërkesë për bashkim familjar me bashkëshorten, për shembull, i legalizon certifikatën e martesës).

Pasi Ambasada italiane të ketë konfirmuar praninë e lidhjes familjare, Kuestura procedon me fshirjen e emrit të familjarit nga Sistemi Informativ Shengen. Nga ky çast kërkesa e bashkimit familjar ndjek rrugëtimin e zakonshëm të këtyre lloj kërkesash deri lëshimin e nulla-ostës për familjarin.

KUJDES

Sic saktëson ministria e Brendshme me qarkoren n. 738 të 17 shkurtit 2009, për lëshimin e autorizimit të bashkimit me familjarin që rezulton i shënuar në Sistemin Informativ Shengen, nevojitet që Sporteli Unik të verifikojë paraprakisht (pra përpara se të fillojë rrugëtimi i praktikës së fshirjes së masës së dëbimit) që kërkuesi plotëson të gjitha kushtet e parashikuara me ligj për bashkimin familjar, me një fjalë që ai të ketë:

1. një strehim të përshtatshëm, të dokumentuar me certifikatën e përshtatshmërisë së strehimit (e ashtuquajtura "idoneità alloggiativa") që lëshohet nga Zyra Teknike e Komunes ku ndodhet banesa ose përmes certifikatës higjienike sanitare të lëshuar nga ASL (Ndërmarrja Shëndetësore Lokale) kompetente për territorin.

2. të ardhura vjetore jo më të ulëta se shumata e çekut social e rritur me gjysmë çeku për çdo familjar që kërkon të sjellë. Për vitin 2009, INPS ka përcaktuar vlerën e çekut social në 5.317,65 euro. Për bashkimin familjar me dy apo më shumë bij nën moshën katërmbëdhjetë vjeçare kërkohet që paraqitësi i kërkesës të ketë të ardhura, të paktën, sa dyfishi i çekut social. Ligji parashikon që kërkuesi mund të mbledhë të ardhurat e tij me ato familjareve të tjerë me të cilët bashkëjetojnë (kështu nëse burrë e grua jetojnë në Itali e burri paraqet kërkesë për bashkim familjar me prindërit, mund të paraqesë jo vetëm deklaratën e të ardhurave të veta por edhe të gruas).

Përfundimisht mund të thuhet që për të marrë autorizimin për bashkim familjar dhe vizën përkatëse të hyrjes, është e nevojshme që kërkuesi të ketë strehim të përshtatshëm dhe të ardhura të mjaftueshme ndërsa familjari që do të hyjë në Itali nuk duhet të përbëjë rrezik konkret dhe aktual për rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

Përgatiti Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE É ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORE / IN REDAZIONE Ketii Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

shqiptari i italisë
l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i
Bota shqiptare
gazeta e shqiptarëve në itali



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 24 maj 2009.

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND

Humbja e vendit të punës, cilido qoftë shkaku, nuk përbën motiv të vlefshëm për tërheqjen e lejes së qëndrimit të punonjësit dhe të familjarëve të tij, sipas ish nenit 22, paragrafi 11 i dekretit legjislativ nr. 286/98.

Ligji italian, në fakt, i njeh punonjësit të huaj mundësinë e qëndrimit në Itali me qëllim që ai të mund të gjejë një vend tjetër pune.

Në rast se punonjësi humbet vendin e punës, për shkak të dorëheqjes apo të heqjes nga puna, dhe ka një leje qëndrimi të vlefshme mund:

1. të ndërrojë vend pune, e të zgjedhë një tjetër qoftë e varur qoftë e pavarur;

2. të regjistrohet në listat e të papunëve të Qendrës për Punësimin, për periudhën e mbetur të kohëzgjatjes së lejes



së qëndrimit e sidoloftë për një periudhë jo më të shkurtër se 6 muaj (me përjashtim të të huajve me leje qëndrimi për punë stinore).

Për t'u regjistruar, i huaji duhet të paraqitet në Qendrën për Punësimin, brenda 40 ditëve nga data e humbjes së vendit të punës dhe përpara se t'i skadojë leja e qëndrimit, për të deklaruar aktivitetin e kryer deri atëherë dhe gatishmërinë e menjëhershme për një punë tjetër. Në çastin e regjistrimit do t'i kërkohet të tregojë lejen e qëndrimit që duhet të jetë ende e vlefshme.

Ministria e Punës ka sqaruar që, edhe shtetasit e huaj në pritje të përtëritjes së lejes së qëndrimit mund të regjistrohen në Qendrat për Punësimin në rast

HUMBJA E VENDIT TE PUNES

Ç'NDODH ME LEJEQËNDRIMIN

Humbja e vendit të punës, cilido qoftë shkaku, nuk përbën motiv të vlefshëm për tërheqjen e lejes së qëndrimit të punonjësit dhe të familjarëve të tij, sipas ish nenit 22, paragrafi 11 i dekretit legjislativ nr. 286/98.

se humbasin vendin e punës. Në këtë rast duhet të tregojnë kuponin postar që dëshmon paraqitjen e kërkesës së përtëritjes së lejes së skaduar.

Pas regjistrimit emri i punonjësit të huaj do të futet në listën e Qendrës për Punësimin për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së lejes së qëndrimit e sidoloftë (me përjashtim të punës stinore) për një periudhë jo më të shkurtër se gjashtë muaj (neni 37 Dekreti i Presidentit të Republikës 394/99)

Përtëritja e lejes së qëndrimit Nëse në çastin e skadimit të lejes së qëndrimit, shtetasit e huaj nuk ka gjetur një vend pune të ri, duhet t'i kërkojë Kuesturës kompetente, me anë të kompletit postar të formularëve, përtëritjen e lejes, duke i bashkangjitur

kërkesës, veç dokumenteve të tjerë edhe një kopje të certifikatës së regjistrimit në listat e Qendrës për Punësimin.

Kuestura do t'i lëshojë një leje qëndrimi për pritje punësimi me kohëzgjatje gjashtëmuajore.

Nëse gjatë këtyre gjashtë muajve shtetasit e huaj punësohet, duhet të nënshkruajë një kontratë të re qëndrimi (formulari Q) dhe t'i nisë Kuesturës kompetente, kompletin e formularëve për kërkesën e konvertimit të lejes së qëndrimit nga leje në pritje punësimi në një leje për punë të varur

Por nëse brenda gjashtë muajve nuk gjen një vend pune, nuk i mbetet tjetër veçse të kthehet në Atdhe.

Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it

Kujt i takon kompensimi për papunësinë
Praktikisht është një shumë në para që i takon punonjësve të varur të siguruar për papunësinë që nuk varet nga vetë punonjësi, i cili papritur gjendet i papunë, pra pa rrogë, për këto motive: licencim, pezullim për mungesë pune, skadim të kontratës. Nuk kanë të drejtë për kompensim ata që vullnetarisht heqin dorë nga puna, me përjashtim të grave me leje lindjeje dhe të punonjësve që japin dorëheqjen për motive të drejta (mosdhënie e rrogës, ngacmime seksuale, modifikim me përkeqësimi i detyrave të punës, mobbing). Kompensimi u takon edhe punonjësve që janë pezulluar nga ndërmarrje që goditen nga ngjarje të përkohshme që nuk shkaktohen as nga punonjësit e as nga punëdhënësi (mungesë pune, krizë tregu). Punonjësit e huaj me lejeqëndrim për punë stinore nuk kanë të drejtë për këtë kompensim pasi janë të përjashtuar nga detyrimi i sigurimit për papunësinë.

Kushtet

Për të marrë këtë kompensim është e nevojshme që punonjësi të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë në gjendje papunësie, pra të jetë pa punë. Gjendja e papunësisë fitohet duke u paraqitur personalisht në Qendrën për Punësimin, kompetente për territorin, dhe duke nënshkruar një deklaratë me të cilën punonjësi dëshmon punën e kryer më parë dhe gatishmërinë e menjëhershme për të filluar punë;
- të ketë paguar, në dy vitet që paraprijnë datën e ndërpres së marrëdhënies së punës, kontributin për papunësinë e pavarur nga punonjësi;
- të ketë të paktën një vit kontribute (të barabartë me të paktën 52 kontribute javore në dyvjeçarin që paraprin datën e ndërpres së marrëdhënies së punës);
- të jetë i aftë për punë.

KOMPENSIMI PËR PAPUNËSINË

I huaji që pushohet nga punë, nëse përmbush kushtet e parashikuara me ligj, ka të drejtë për një shumë në mbështetje të të ardhurave që quhet kompensim papunësie. Ky kompensim ka për qëllim të mbrojë punonjës në çaste të caktuara të jetës së tij profesionale, duke i siguruar ndihmë ekonomike që zëvendëson të ardhurat nga puna.

Kërkesa

Kërkesa, e përbërë nga formulari DS 21, paraqitet në selinë e INPS-it (ose në Qendrën e Punësimit kompetente për rezidencën ose përmes Patronatit), brenda 68 ditëve nga pushimi nga puna. Kërkesës i duhen bashkëngjitur:

- deklarata e përgjegjësisë e përpiluar nga punëdhënësi i fundit (formulari DS 22). Në alternativë, është e mundur të paraqitet një deklaratë zëvendësuese me të cilën të vetëcertifikohen informacionet lidhur me marrëdhënien e fundit të punës;
- certifikata e regjistrimit në listat e të papunëve;
- kërkesa e zbritjeve fiskale Irpef.

Formularët DS 21 dhe DS 22 dhe kërkesa e zbritjeve Irpef mund të gjenden, përveçse në zyrat e Inps-it, në web-site-in www.Inps.it, në seksionin "moduli".

Shuma

Kompensimi i zakonshëm që paguhet nga 1 janari 2008 është sa 60% e rrogës mujore bruto për gjashtë muajt e parë, sa 50% për muajin e shtatë dhe të tetë dhe sa 40% për muajt

në vazhdim. Punonjësve të pezulluar u paguhet kompensim sa 50% i rrogës. Kufiri maksimal i shumës së kompensimit është 858,58 euro që arrin deri në 1.031,93 euro për punonjësit që kanë rrogë mujore bruto mbi 1.857,48 euro. Këta kufij rriten nga viti në vit sipas ndryshimit të treguesve Istat.

Kohëzgjatja

Nga 1 janari 2008 kohëzgjatja e dhënies së kompensimit të papunësisë është rritur nga 7 në 8 muaj, dhe 12 për ata që kanë moshë mbi 50 vjeç. Punonjësve të pezulluar u takon, për të shumtën, 65 ditë.

Humbja e të drejtës së kompensimit
Pagesa e kompensimit të papunësisë ndërpritet kur punonjësi:

- ka marrë kompensimin për të gjitha ditët e parashikuara;
- nis një punë të re për një periudhë më të gjatë se 5 ditë të njëpasnjëshme;
- nis të marrë pension (pension për vjetërsi në punë, për mbushjen e moshës);
- hiqet nga listat e të papunëve.

Ankimimi

Në rast se kërkesa për të marrë kompensim papunësie hidhet poshtë, i interesuari mund t'i paraqesë ankimim, në kartë të thjeshtë (pa pullë-taksë) Komitetit Provincial të Inps-it, brenda 90 ditëve nga data e marrjes së letrës me të cilën i njoftohet hedhja poshtë e kërkesës. Ankimimi mund të bëhet pranë sporteleve të Inps-it, t'i dërgohet Inps-it me postë rekomandë me lajmërim marrjeje, apo të paraqitet përmes një prej Patronateve të njohura me ligj.

Kompensimi i papunësisë me kushte të reduktuara

Ky kompensim është një shumë në mbështetje e të ardhurave që u takon punonjësve që, pasi kanë kryer një punë të varur për një periudhë të kufizuar, nuk kanë 52 kontribute javore gjatë dy vjetëve të fundit por që kanë punuar të



shqiptari
italiese.com
portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE

paktën 78 ditë gjatë vitit të fundit, përfshirë festat dhe mungesat e paguara (për sëmundje, leje lindjeje etj.).

Kushtet

Për të fituar të drejtën e kompensimit me kushte të reduktuara është e nevojshme që punonjësi të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë të paktën dy vjet sigurime për papunësinë e pavullnetshme (pra duhet pasur të paktën një kontribut javor të paguar përpara dyvjeçarit pararendës të vitit kur kërkohet kompensimi);
- të ketë kryer punë të varur për të paktën 78 ditë në periudhën e referimit.

Kërkesa

Kërkesa për kompensim papunësie me kushte të reduktuara i duhet paraqitur Inps-it (me formularin DS 21) brenda 31 marsit të vitit pasardhës së atij kur ka pushuar marrëdhënien e punës. Kërkesës i duhen bashkëngjitur:

- deklarata (formulari DL 86/88bis) e punëdhënëseve pranë të cilëve është punuar gjatë vitit pararendës;
- kërkesa për zbritjet fiskale Irpef.

Formularët DS 21 dhe DL 86/88bis dhe kërkesa e zbritjeve Irpef janë të disponueshme, përveçse në zyrat e Inps-it, në web-site-in www.Inps.it, në seksionin "moduli".

Kompensimi është sa 35% e pagës ditore mesatare për 120 ditët e para dhe sa 40%, për ditët në vazhdim, brenda kufijve të një shume mujore maksimale bruto prej 844,06 euro, që arrin deri në 1.014,48 euro për punonjësit që kanë rrogë mujore bruto mbi 1.826,07 euro.

Kompensimi u takon punonjësve për periudhat e papunësisë gjatë vitit diellor pararendës dhe për një numër ditësh të barabartë me ditët e vitit pararendës kur është punuar, maksimumi deri në 180 ditë, përfshirë edhe ato që mund të jenë kompensuar me kushtet e kompensimit të zakonshëm.

Përgatiti Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it

ISTITUTO LUCE
PRESENTA



ALBANIA

IL PAESE DI FRONTE

REGIA
ROLAND SEJKO
MAURO BRESCIA

12 MAGGIO 2009, ORE 22
HISTORY CHANNEL



REGIONE LAZIO

N E L L E M I G L I O R I L I B R E R I E



QUARTA PARETE

teatri i shqiptarëve në Itali

Një vit pas formimit të saj, dhe pas debutimit të parë në skenat e Trentinos, kthehet kompania "Quarta Parete". Këtë herë me një tjetër pjesë, shqiptare por jo vetëm kaq, që për herë të parë e ka shpënë kompaninë e shqiptarëve trentinë edhe jashtë Italisë, pikërisht në festivalin e Monodramës së Kosovës. Por ky është vetëm fillimi. Projektet nuk reshtin së pasuruari.

Ata janë çifti i artistëve Dardana Bërdyna dhe Albert Dedja, që një ditë të largët shpresash e topitjesh nga ato që ndryshuan historinë e Shqipërisë, jo më pak se 18 vjet të shkuara, zbarkuan brigjeve italiane, me një ëndërr të çuditshme. Nuk

ishin shqiptarët e periferive ekonomike e intelektuale me frustrimin e pllakosur në fytyrë, por me një ëndërr paksa të veçantë, atë të artistit e të intelektualit shqiptar që i rri ngushtë censura dhe izolimi i Shqipërisë së atëhershme. Italia ishte vendi i artit, dhe porta e parë e perëndimit ku gëlonte arti bashkëkohor. Në këtë derë donte të trokiste çifti shqiptar që braktisi teatrin Aleksandër Moisiu të Durrësit për të ndjekur një ëndërr që nuk do t'i tjetërsonte nga natyra e tyre thelbësore, ajo e të qenët artistë. Pas vitesh jete migruese, mes plot vështirësish, para një viti mori formë e para shoqëri teatrale shqiptare, që zuri vend menjëherë në skenat e një prej krahinave më të suksesshme e më krijuese të Ital-

Grupi teatral i ngritur është e vetmja përvojë sipërmarrjeje teatrale e artistëve shqiptarë në Itali. Ata janë çifti i artistëve Dardana Bërdyna dhe Albert Dedja, që 18 vjet të shkuara braktisi teatrin Aleksandër Moisiu të Durrësit për të ndjekur një ëndërr që nuk do t'i tjetërsonte nga natyra e tyre thelbësore, ajo e të qenët artistë. Pas vitesh jete migruese, mes plot vështirësish, mori formë e para shoqëri teatrale shqiptare, që zuri vend menjëherë në skenat e një prej krahinave më të suksesshme e më krijuese të Italisë. Ata sjellin nga pak Shqipëri, nga pak jetë migruese, por mbi të gjitha art, me stilistikë, mesazhe, e shprehi të teatrit bashkëkohor.

isë. Ata sjellin nga pak Shqipëri, nga pak jetë migruese, por mbi të gjitha art, me stilistikë, mesazhe, e shprehi të teatrit bashkëkohor. Pas balerinëve që u shndërruan në simbol të shqiptarit të mirë, listës së Shqipërisë kreative që ka zbarkuar në Itali i janë shtuar edhe shqiptarët e Quarta Parete-s.

Mbërrin projekti i dytë i realizuar prej tyre, por që këtë herë nuk është histori shqiptarësh, me Shqipëri e Ballkan që pulson skenës duke diktuar ritmin e shfaqjes, ose të paktën prania e elementeve tradicionale të teatrit të tyre të mëparshëm nuk perceptohen këtë herë në mënyrë kaq të hapur. Pas tekstit të Vorp-sit, të reinterpretuar e përpunuar vitit të kaluar, dra-

QUARTA PARETE

Teatri i shqiptarëve në Itali

vijon nga faqja 9

maturgu i përzgjedhur këtë herë është polaku Slawomir Mrozek, një prej kolosëve të dramaturgjisë bashkëkohore, që di të flasë për migrim, sikletshmërinë e jetës në mënyrë universale.

Pjesa është "Ditë vere", një dramë komike, ku dy njerëz takohen në një vend ndërsa të dy kanë shkuar aty për të bërë vetëvrasje, secili për arsye të ndryshme, i pari sepse tepër i përkëdhelur nga jeta në anën materiale por pa asnjë grimcë dashurie, kurse i dyti sepse durimsosur nga rendja pas utopive. Secili alterego i tjetrit, të dy në prag vetëvrasjeje në një vend anonim që mund të ishte kudo, në një skenë të zhveshur që hapet me klithmat e pulëbardhave dhe projeksionet e tyre që rrjedhin mbrapsht, duke trishtuar e ngjallur dëshpërim. Ndërsa në skenë duket një litar gjigant e një pistoletë gjigante të cilat janë mjetet ekstreme që u nevojiten dy protagonistëve. Ndërkohë që hapësira mbushet me ankesat e tyre të lodhshme e të mërziqshme, një grua kalon andej, Dardana Bërdyna në rolin e ndjellëses së jetës, me një bisht palloi në dorë, e detaje të vogla që përmbledhin bukurinë e jetës, dhe një veshje të gjelbër që tërheq vështrimin dhe simbolizon shpresën, deri aty sa dy fatkeqit që kanë vendosur t'i japin fund përvuajtjes në këtë botë, harrojnë përse kanë shkuar në atë vend të tmerrshëm dhe i kthehen jetës, duke ndjekur gruan e duke harruar të vetëvriten. Sepse ka të tilla gjëra në këtë botë që të bëjnë të heqësh dorë nga të disfatizmi dhe të shijosh jetën e gjërave të vogla, e dashurive të vogla e të mëdha, në gjithë format e mundshme e të imagjinueshme. Dhe mjetet ekstreme të vetëvrasjes do të shndërrohen në objekte argëtuese që do të humbasin vlerën fillestare, por duke ru-



Faqe e kopertinës Dardana Bërdyna merr lulet nga spektatorët në përfundim të shfaqjes. Këtu, Dardana dhe Albert Dedja, dy bashkëshortët themelues të shoqërisë teatrale "Quarta parete" në Trento. Fotot në faqet pasuese nga shfaqjet e vëna në skenë prej tyre

ajtur grotesken e përmasave të tyre dhe të atmosferës së vendit anonim ku do të konsumohej lamtumira me këtë botë.

Mesazhi është bindës, gjithçka vërtitet rreth dashurisë, dhe shpresës që lidhet me të, buron e çon tek ajo në një rreth vicioz që lejon të kesh arsye për të jetuar. Mesazhi i fortë ka bërë që të jetë më shumë se një psiko-dramë edhe një lloj terapie për një shoqëri të pasur post-moderne kur shumëçka vërtitet rreth të hollave duke shtyrë larg shpirtëroren.

Por nuk mbaron këtu. Të tjera projekte vazhdojnë të ngjizen e të propozojnë tema të reja, duke iu shtuar repertorit tejet dinamik të kompanisë së re shqiptare. Në skenat italiane do të afishohen sërish shfaqjet e tyre, ndërsa ende mungojnë skenave shqiptare, edhe pse Quarta Parete personifikon teatrin shqiptar në trajtën e tij më të mirë.

INTERVISTA

nga Marjola Rukaj

Shqiptari i Italisë: Është vështirë të bësh teatër në Trentino?

Dardana: Trentino ka një realitetet teatral shumë të pasur dhe shumë dinamik. Ka numrin më të lartë të kompanive teatrale në raport me popullsinë, të paktën kështu thonë statistikat. Ka shumë shkolla teatri, zhvillohet stina e prozës e një niveli shumë të lartë, vijnë kompani nga gjithë Italia e nga jashtë shtetit, emrat më të rëndësishëm të teatrit ndërkombëtar. Në Trentino vijnë njerëz nga vende të ndryshme dhe fakti që ne kemi hyrë në jetën teatrale trentine nuk është një e re absolute sepse kjo botë është e mësuar me prurje nga më të ndryshme për sa i përket gjeografisë dhe kulturës. Nuk kemi pasur asnjë vështirësi për të hyrë në botën teatrore trentine e madje kemi pasur shumë mbështetje nga komuna nga provinca e Trentos që na kanë dhënë dorën e parë për të realizuar pjesët tona. Edhe publiku na ka treguar shumë interes dhe kemi pasur një kënaqësi të jashtëzakonshme.

Fillimisht pjesa e parë që vutë në skenë ishte diçka që kishte të bënte me migrantët dhe tëhuajtjen e dyfishtë, kurse pjesa e Mrozhekut ka të bëjë me një temë universale. Cili është kriteri për zgjedhjen e temave?

Dardana: Ne në përgjithësi kemi dëshirë të trajtojmë tema që kanë të bëjnë me jetën tonë, me emigracionin, integrimin që karakterizon ne si qytetarë të rinj të kësaj shoqërie në mos konservatore, pa dyshim të pamësuar me emigracion siç është Italia në përgjithësi dhe Trentino në veçanti. Megjithatë ky nuk është një kufizim për zgjedhjet tona. Është natyrisht boshti qendror i temave tona, sepse kjo na personifikon më mirë, reflekton jetën tonë, ëndrrat tona, problemet tona



dhe bën që t'i përcjellim më mirë mesazhet publikut në këtë drejtim. Është e rëndësishme që teatri të ketë një tematikë më të gjerë dhe duke qenë fjala mjeti komunikues pret tema nga më të ndryshmet dhe shkon përtej temave të migracionit dhe të jetës ku ne marrim pjesë.

Albert: Kjo pjesë është zgjedhur në këtë fazë kur kemi një

tjetër pjekje nga ana profesionale. Në këtë pjesë të Mrozhekut nëpërmjet autorit gjetëm një botë të ngjashme me të tonën sepse Mrozheku ka jetuar në Poloni në vitet e komunizmit. Ai shkante botën perëndimore dhe atë lindore pothuaj nga pikëpamja jonë sepse kjo pjesë është jashtëzakonisht biografike këtij autori. Një nga personazhet, nuk e di nëse për rastësi apo me dashje,

Kemi dëshirë të trajtojmë tema që kanë të bëjnë me jetën tonë, me emigracionin, integrimin që karakterizon ne si qytetarë të rinj të kësaj shoqërie në mos konservatore, pa dyshim të pamësuar me emigracion siç është Italia në përgjithësi dhe Trentino në veçanti. Megjithatë ky nuk është një kufizim për zgjedhjet tona. Është natyrisht boshti qendror i temave tona, sepse kjo na personifikon më mirë, reflekton jetën tonë, ëndrrat tona, problemet tona dhe bën që t'i përcjellim më mirë mesazhet publikut në këtë drejtim.

një nga personazhet quhet Sfor si Sfortunato. Ne të kemi munduar të personifikojë figurën e Mrozhekut që përfaqëson atë përqendrim që kishin njerëzit gjatë komunizmit tek utopia, duke besuar në atë që është e porealizueshme. Kështu i largoheshin realitetit. Kjo ndodhte ne shoqërinë që kemi njohur ne në Shqipëri. Kurse personazhi tjetër quhet Fortunato sepse është ai që ka pasur

vijon në faqen 12



Specialisti për fluturime charter, low cost, fluturime linje dhe tragete

- Tiranë
- Durrës
- Vlorë

Bonus për ulje çmimi prej 20 eurosh, nëse na telefonon e thua "Offerta giornale"!!!

Prenotime Fluturim, Hotel, Makina me qira, Tragete dhe Trena në Shqipëri edhe me telefon, me çmime konkurruese.

TURISADRIA VIAGGI
VIA MAZZINI 119/C 47042 CESENATICO (FC)
Tel. 0547.82492– 0547.674221 - 340.7089484
www.volialbania.it

vijon nga faqja 11

fat, në jetë i ka pasur të gjitha, pasuritë çfarëdolloj gjëje, e vetmja gjë është që gjithçka ka kërkuar ka qenë e sferës materiale, pra ka harruar të ëndërrorë. Jeta e tij është përqendruar vetëm tek grumbullimi. Kurse tjetri ka ëndërruar gjithmonë gjëra që nuk realizoheshin asnjëherë. Të dy janë të zhgënjyer nga jeta pikërisht sepse kanë ndjekur objektiva që i kanë larguar nga jeta. Janë dy aspekte që nëse përndiqen në mënyrë ekstreme bën që të harrosh lumturinë e jetës, lumturinë e gjërave të vogla, e realitetit ku mund të kthesh kokën e të shikosh më me pozitivitet gjërat. Kjo është ajo që na lidh me Mrozhekun sepse kështu kemi mundësi të krahasojmë jetën tonë të mëparshme në shoqërinë shqiptare dhe atë të sotmen këtu. Siç tha edhe Dardana, pasuria nuk e ndryshon aspak këtë lloj statike. Fakti që vende perëndimore si Suedia, janë vende me numrin më të lartë të vetëvrasjeve, ndërkohë që aty mirëqenia është më e larta në Evropë. Kjo do të thotë që të synosh vetëm anën materiale mund të sjellë në një varfërim të anës shpirtërore dhe kjo mund të çojë në ndonjë zgjedhje ekstreme. Këto dy personazhe përplasën dy filozofi jete. Kjo na lidh neve me Mrozhekun.

Përse tani së fundi zgjodhët këtë pjesë të Mrozhekut?

Dardan Berdyna: Kishim lexuar disa pjesë të tij. Është një autor që merret shumë me probleme të emigracionit. Ndërsa po kërkonim vepra për pjesët tona na ra në dorë edhe kjo dramë që fliste për vetëvrasjen si një mënyrë për të folur për jetën. Kjo na u duk një temë shumë interesante sepse vetëvrasja është një fenomen që jo vetëm këtu ku ne jetojmë në Trento por edhe në Shqipëri, është një temë shumë delikate. Kjo na dha shtysë të reflektonim për vlerat që duhet të zgjedhë njeriu në jetë. Ajo që del nga kjo pjesë është se si nga njerëzit që janë më të emargjinuar mund të bëhen disa refleksione shumë internate për vlerën e

QUARTA PARETE

Teatri i shqiptarëve në Itali



Ne sjellim në të vërtetë edhe një lloj tradite diktoriale në drejtimin e pjesëve sepse imponojmë pikëpamjen regjisoriale. Ka disa shkolla ku aktori lihet i lirë të shprehë vetveten kurse ne nuk preferojmë këtë ndoshta sepse i ngelemi besnikë traditës diktoriale.

jetës dhe rëndësinë e gjërave pas të cilave njeriu duhet të kapet për të jetuar.

Ishte pra një temë universale, nuk kishte të bënte ngushtësisht me emigracionin?

Dardana: Po, është një temë universale që ka të bëjë me njeriun në përgjithësi, me psikologjinë e njeriut në momente të vështira. Veçanërisht të njeriut që gjendet në situata si kjo ku gjendet vendi ynë, si pasojë e këtyre ndryshimeve masive që i kanë ndodhur shoqërisë sonë. Është interesante se i njëjti fenomen është shumë i pranishëm në shoqëritë perëndimore, në

shoqëritë e mirëqenies ku pasuria bashkëjeton me depresionin, por edhe në shoqëritë si e jona që ka pësuar ndryshime të rënda e tronditëse, dhe që gjendet në një transformim të vazhdueshëm. Gjithë vendet e lindjes janë vende ku ndiqet utopikisht ëndrra dhe nuk realizohet asnjëherë, ndërsa nga ana tjetër është shoqëria perëndimore me ëndrrën materiale dhe të konsumit por që nuk arrin të plotësojë nevojat e tjera të njeriut. Dy personazhet e pjesës përfaqësojnë këto dy botë të vendosura përballë njëra-tjetrës, me probleme të ndryshme të cilave synojnë tu japin të njëjtën zgjidhje nëse kjo mund të quhet kështu.

Janë dy njerëz që e gjejnë veten të shtyrë drejt një zgjedhjeje kaq ekstreme. Në të vërtetë nuk i jemi larguar shumë tremave që në përgjithësi na pëlqen të trajtojmë si kompani teatrale. Pjesa përmbledhet në ekzistencën e dy personazheve kryesore që janë si dy përfaqësues të dy botëve me natyrë të ngjashme, por që në rrugëtimin në jetë kanë pasur drejtime të ndryshme. Përfaqësuesi i realitetit tjetër siç ishte ai i botës së lindjes ku synimi i gjërave ishte një ëndërr, por realizimi i ëndrrës ishte një utopi. Tjetri synon realizimin e nevojave të veta materiale por pa asnjë aspekt emotiv. Bëhet fjalë për dy personazhe që plotësojnë njëri-tjetrin sepse janë botë për të cilat njerëzit kanë nevojë njëkohësisht në mënyrë të harmonishme.

Ju sapo jeni kthyer nga Festivali i Monodramës në



Kosovë. Si ishte kjo përvojë?

Dardana: Ishte hera e parë që ne merrnim pjesë në një festival ndërkombëtar dhe për ne ishte një emocion i jashtëzakonshëm. Morëm pjesë me punën tonë të vjetshme "La mano che non morì". Ky ishte një festival ndërkombëtar dhe ne në Kosovë shkuam si përfaqësues të Italisë. U krijua një situatë disi absurde sepse na u desh të recitonim italisht duke qenë shqiptarë. Gjithkush fliste gjuhën e vendit prej nga vinte dhen e nuk kishim si të bënim ndryshe. Duket pak absurde, sepse kthehesh në vendin tënd duke përfaqësuar një vend tjetër dhe duke folur në një gjuhë tjetër. Por u prit shumë mirë si nga publiku si nga komisioni që vlerësonte pjesët. Kritika e shtypit të Kosovës vlerësoi si temën shumë aktuale si mjetet stilistike.

vijon në faqen 14

Nga 27 prilli deri më 9 maj



LA SPESA INTELLIGENTE

Djathë mozzarella
në qese g 125x4
Euro 3,38 për kg

Land ~~7,99~~

1,59
4 pz x 125g

Fermente aktive luleshtrydhe / Multi-fruta
ml 100x6 Euro 2,48 për L ~~7,89~~

Land fermenti

1,49
njësia

Pica margarita
g 315 Euro 1,87 për kg ~~0,99~~

ENGAIRE

0,59

Filetë merluci
g 400 Euro 4,88 për kg ~~2,65~~

ENGAIRE

Filetti di Merluzzo

1,95

...E DISA SHEMBUJ TË MALLRAVE TANË

Ton në vaj ulliri
g 160 Euro 5,94 për kg

ATHENA

0,95

Cola
ml 1.500
Euro 0,46 për L

Bitnes Cola

0,69

Solucion larës pjatash plus uthull / limon
ml 1.250
Euro 0,79 për L

Dexal

0,99
njësia

Shkumë për dush të ndryshme
ml 300
Euro 3,30 për L

Near

0,99
njësia

EUROSPIN MË | MADHI GRUP DISCOUNT ITALIAN ME MËSE 750 PIKA SHITJEJE - PËR TË NJOHUR PIKËN MË TË AFËRT KONSULTO FAQET TONA INTERNET WWW.EUROSPIN.IT

© 2009 - Fotografite janë vetëm për ilustrim
 Çmimet dhe karakteristikat mund të ndryshojnë pa paralajmërim edhe për shkak të gabimeve të shtypit. Oferta është e kufizuar për sasi konsumi familjar.

vijon nga faqja 13

Në Shqipëri organizohen disa festivale teatrale, keni menduar të merrni pjesë në to?

Dardana: Duke qenë një kompani e re, nuk kemi shumë përvojë në organizimin e pjesëmarrjes në festivale por pjesëmarrja në këto festivale është diçka që do të na pëlqente jashtëzakonisht shumë.

Sa rëndësi ka shkolla shqiptare prej nga vini në këtë integrim në botën teatrale trentine?

Dardana: Shkolla shqiptare siç pamë këtu na ka dhënë shumë, edhe pse na mungon disi pjesa e teatrit modern që jemi munduar ta përmbushim duke jetuar këtu, duke gërmuar shumë. Baza e shkollës sonë është shumë e fortë dhe na ka formuar me mjete shumë të mira, për të përballuar këtë lloj teatri që bëhet këtu. Nuk e kemi ndier veten aspak inferiorë. Përkundrazi tashmë është krijuar bindja për cilësinë e shqiptarëve në teatër, dhe ata njihen e vlerësohen jashtëzakonisht.

Albert: Zgjedhjet tona skenografike dhe regjisoriale priten me shumë interes sepse këtu ka shumë shkolla teatrale, që vënë në krahasim midis tyre programet, dhe teknikat dhe ngelen gjithmonë shumë të tërhequr nga ajo që shikojnë. Herë pas here krijohen debate sepse ne e përpunojmë shumë pjesën. Krijohet një atmosferë shumë pozitive. Ne sjellim në të vërtetë edhe një lloj tradite diktatoriale në drejtimin e pjesëve sepse imponojmë pikëpamjen regjisoriale. Ka disa shkolla ku aktori lihet i lirë të shprehë vetveten kurse ne nuk preferojmë këtë ndoshta sepse i ngelemi besnikë traditës diktatoriale.

Cili është mesazhi i kësaj pjese?

Albert: Këto personazhe që përfshihen në një pjesë shumë filozofike. Doli në të vërtetë një pjesë shumë e lodhshme. Ne kemi synuar shumë në anën e



QUARTA PARETE

mesazhit, për të bërë që të reflektohet. Është një komedi dramatike, nuk kemi kërkuar, si të thuash, "risata facile" si në Zelig. Kemi kërkuar nëpërmjet kësaj të reflektojmë për vetëvrasjen duke shtyrë në largimin nga ideja e vetëvrasjes, duke u përqendruar tek dashuria që largon nga vetëvrasja. Njeriu nëse harron dashurinë për veten, për të tjerët për natyrën, për jetën, përfundon në një gjendje vetmie totale dhe kjo çon në zgjedhje ekstreme si kjo. Mesazhi është tek një frazë në fund me të cilën mbyllet pjesa, palumtura dallohet nga fakti se mund të jetojmë shumë mirë pa të, por ne e kultivojmë atë me fanatizëm. Pjesa me sa duket ka arritur të përcjellë më së miri këtë mesazh sepse këtu në Trento, Asl-i (Ndërmarrja shëndetësore), ka pasur idenë të na përfshijë në projektin *Invito alla vita* që është një projekt që synon parandalimin e vetëvrasjes. Dhe nëpërmjet pjesës sonë kanë vendosur të përcjellin këtë mesazh.

Kohët e fundit ju keni dhënë një intervistë për D di Repubblica. Përfundimi i gazetës ishte "disa shqiptarë kanë ardhur në Itali në kërkim të jetës së patinuar që shikonin televizioneve italiane, e disa të tjerë për të gjetur atdheun e Calvinos e të de Chiricos". Ç'ishte për ju Italia në atë periudhë duke vazhduar këtë temë?

Albert: Ne kemi qenë më me fat se një pjesë e mirë e të afërme apo miqve tanë sepse kemi pasur fatin të studiojmë e më pas edhe të punojmë në punë të kënaqshme. Kjo bënte që ne në një farë mënyre të kishim të tjera nevoja. Kishim një farë kurioziteti e interesi për atë që ndodhte jashtë vendit tonë sepse edhe vetë natyra e këtij profesioni bënte që të largoheshim qoftë ehe në mënyrë virtuale nga realiteti i Shqipërisë së atëhershme, sepse na duhej të merrnim in-

formacionet mbi artin modern, edhe pse të filtruar nga censura. Ne në televizion gërmonin të gjenim informacionet që na nevojiteshin për artin modern, për pikurën, për muzikën. Kishim nevojë të zgjerohim horizontet tona. Ëndrra për të njohur perëndimin nuk mbaronte vetëm me anën ekonomike. Kishte shumë artistë të artit, të pikurës, të muzikës që na frymëzonin e na ngjallnin kureshtje. Ishim shumë të rinj, ishim studentë dhe kjo shkrihej me një entuziazëm dhe një nevojë për t'iu bashkuar artit bashkëkohor. Ndiem nevojën për të zbuluar atë lidhjen e natyrshme që mund të ketë një njeri me artin e kohës së vetë. Ne vinim nga një shoqëri e varfër, e kufizuar për shkak të ideologjisë dhe nëpërmjet televizionit gjenim një dritare në këtë pjesë që na ishte cunguar. Kjo na solli një liri mendore, një liri virtuale, jetonim kështu me shpresën se edhe ne një ditë do t'i bashkoheshim kësaj bote. Natyrisht njerëzit kanë objektiva të ndryshme në jetë. Ka njerëz që kanë ardhur për arsye ekonomike, ka të tjerë si ne që nuk kishin parësore anën ekonomike sepse ne punonim në teatër në atë kohë dhe nuk kishim probleme ekonomike. Ajo që ne synonim ishte hapja, arritja e atyre objektivave që nuk mund të arrinim në Shqipëri.

Fakti që gazeta si D di Republika, ju intervistojnë, bën që ju të merrni pjesë në fenomenin anti-fobi si të thuash "Ja fytyra jetët e shqiptarëve".

Albert: Rezultati që kemi arritur vjen nga një punë e pareshur mes mijëra vështirësish. Kemi kaluar vite shumë të vështira veçanërisht në fillim të jetës sonë këtu. Por jemi munduar të rezistojmë e të mos largohemi asnjëherë nga arti. Fakti që intervistohemi dhe që ka të tilla komente kaq pozitive është një kënaqësi e jashtëzakonshme për ne por që në njëjtën kohë na vë përpara përgjegjësi të tjera dhe na bëjnë të mbajmë këmbët në tokë. Na bën të kërkojmë të jemi pozitivë dhe të gjitha gjërat që kërkojmë të përpunojmë nga ana profesionale, të materializohen në



Fakti që ne vazhdojmë akoma të merremi me emigracionin do të thotë se ne nuk kemi mbaruar ende së treguari për emigracionin. Kemi ende gjëra për të thënë në këtë drejtim, do të thotë se ka ende gjëra që na ngacmojnë, fantazinë, apo kritikën dhe na shtyjmë të përcjellim mesazhe. Me kalimin e kohës patjetër kjo temë do të humbasë rëndësi, sepse do të vijë një ditë kur do ta gjejmë veten bosh e do të merremi me të tjera tema.

pjesët që ne zgjedhim. Ajo që ne zgjedhim është ajo që ne mendojmë, janë pjesë e atyre që ne akumulojmë në jetën tonë reale. Kur zgjedhim pjesët mundohemi të reflektojmë aty pikëpamjen tonë për këto gjëra. Fakti që ne vazhdojmë akoma të merremi me emigracionin do të thotë se ne nuk kemi mbaruar ende së treguari për emigracionin. Kemi ende gjëra për të thënë në këtë drejtim, do të thotë se ka ende gjëra që na ngacmojnë, fantazinë, apo kritikën dhe na shtyjmë të përcjellim mesazhe. Me kalimin e kohës patjetër kjo temë do të humbasë rëndësi, sepse do të vijë një ditë kur do ta gjejmë veten bosh në këtë drejtim, e atëherë kuptohet do të merremi me të tjera tema.

Cili do të jetë projekti i ardhshëm?

Albert: Kemi një projekt shumë interesant që i kthehet përsëri historive tona shqiptare, por nuk do të zbulojmë të gjithë projektin këtu. Nëse shkon ashtu siç mendojmë ne do të jetë diçka shumë e fortë. Me këtë pjesë synojmë t'i kthehemi sërish jetës sonë, traditave, Shqipërisë. Është një rishikim i një historie mesjetare shqiptare që lidhet edhe me problemet tona aktuale. është një pjesë shumë angazhuuese, me shumë aktorë dhe që do të kërkojë shumë investim financiar. Në kohë krize si kjo e sotmja kjo nuk është thjesht një fjalë goje, por projekti ekziston.

Bisedoi Marjola Rukaj

NJË LIBËR I RI I BËSHKËPUNËTORIT TONË GIOVANNI ARMILLOTTA

Popujt europianë pa shtet. Udhëtim mes etnive të harruara



Shtëpia botuese romane Jouvence, në fund të marsit 2009 ka botuar librin e Giovanni Armillotta-s "I Popoli europei senza Stato. Viaggio attraverso le etnie dimenticate" (€ 16,00 - 190 pp. - ISBN 978-88-7801-409-1) për serinë Ordine & Caos të drejtuar nga Franco Cardini, Marco Tarchi dhe Danilo Zolo.

Libri i Armillotta-s trajton periudha të fshehura të lashta e bashkëkohore të historisë së atyre që sot njihen si rajone të thjeshta të vendeve njohura europiane: Bretanja (Francë), Katalonja e Vendet Baske (Spanjë), Kornovalja (Britani e Madhe), Laponia (Vendet Skandinave të Rrethit Polar Arktik dhe rusi), Sardenja (Itali), Vendet Ladine (Itali e Francë) etj. Armillotta trajton zona gjeografike e gjeopolitike që kanë përjetuar epoka historike luftërash kundër pushtetit gjithëpërfshirës; memorie të epokave kur këta popuj kishin shtetin e vet me tradita të lashta. Vazhdimësia kohore, na përshkruan se si këta njerëz dolën të mundur në përplasjen me etni të tjera, më të forta fillimisht ushtarakisht e më pas në imponimin administrativ. Me librin e tij, Armillotta na bën të kuptojmë përhumbjen kulturore që shumë prej këtyre etnive kanë përjetuar e përjetojnë në kontakt me "metropolet" fitimtare. Problemi i fashitjes leksikut të lashtë, lufta për kujtimin e origjinës dhe të gjuhës, e shtyn autorin jo vetëm të paraqesë minoritetet e ndryshme ashtu si janë ndarë në Europë, por edhe të tregojë për përpjekjet e atyre të paktëve që përpiqen të mbajnë gjallë krenarinë e popujve që rrezikojnë të zhduken në procesin e asimilimit dhe të homologimit të drejtuar nga ata që njëherë e një kohë ishin pushtues dhe që sot përfaqësojnë legjitimitetin e njohur nga e gjithë bota dhe nga e drejta ndërkombëtare. Mbrojtja e një minoriteti në cilindo territor nuk nënkupton vetëm përkujdesjen për gjuhën. Ekzistojnë përmasa të tjera, që shkojnë nga letërsia deri të revizionizmi historik; argumente që duhen zbrëthyer përmes një studimi të hollësishëm të Shteteve që kanë pushtetin, që shpesh konsiderojnë rajonet e këtyre minoriteteve, në rastin më të mirë, si pasuri turistike, e në rastin më të keq, si vende të përshtatshme për baza ushtarake të huaja. Në hyrje të librit autori flet edhe për Kosovën, Arbëreshët e Shqipërinë. Atmosfera e veprës përmbledhet më së miri me fjalët e Maurizio Vernassa-s që në paraqitjen e librit pohon: "Për të ndërtuar konkretisht Europën e re e të madhe të ëndrrave dhe shpresave tona, Europën e qytetërimit të përbashkët, Europën e lirë nga aktet e rrezikshme dhe të papranueshme nacional-imperialiste dhe për rrjedhojë nga tragjeditë, e hershme dhe të vona, duhet, para së gjithash, të njihen me themel karakteristikat e përbërësve të saj të shumëfishtë historikë, politikë, shoqërorë dhe etnikë".

Albana Temali

Prague Biennale 4, kjo ekspozitë ndërkombëtare në edicionin e saj të katërt por e afirmuar në skenën ndërkombëtare të artit bashkëkohor do të hapet në datat 14 deri më 26 maj 2009. Edhe këtë vit për traditë impenjohet te seksioni Expanded Painting, ku synon të paraqesë një panoramë të paparë e më parë në ndonjë bienale tjetër ku mes të reja në pikturën ndërkombëtare bashkëkohore nga vendet si Gjermania, Polonia, Rumania, Italia, Kina do të sjellë dhe vendet e prekura nga cunami, si Indonezia, Filipine, Malajzia, Singapori, për mos të lënë mënjanë edhe seksionin White Paper Black Bride me artin e lindur në Pragë pas njëzet vjetësh nga rënia e murit të Berlinit. Por jo vetëm kaq, këtë vit mes pjesëmarrësve të tjerë do të jetë edhe një grup artistësh tanë që do të përfaqësojnë seksionin "Albania & Kosovo".

Njoftimin për këtë pjesëmarrje na e dha për "Shqiptari i Italisë" kuratori i sektorit "Kosovo&Albania" - Prague Biennale 4, piktori i mirënjohur dhe galeristi Artan Shabani, i cili në anteprema ofroi edhe fotot e veprave me të cilat artistët do të prezantohen (veprat e të gjithë pjesëmarrësve shqiptarë i gjeni në faqet internet shqiptariitalise.com).

Përzgjedhja, tregon Shabani, kudo është një detyrë mjaft e vështirë, sidomos në artin bashkëkohor. Vështirësitë lidhen mbi të gjitha me relacionet që krijohen me artistët dhe me procedurat që dominojnë në këtë tip organizimi. Por Shabani, si piktor e galerist, jo vetëm që ia arrin të përzgjedhë gjashtëshen që do të përfaqësojë Shqipërinë e Kosovën në Pragë, por po mendon seriozisht të organizojë një Bienale të tillë edhe në Shqipëri.

Artistët e përzgjedhur janë pjesë e një projekti të Bienales s Pragës që konsiston në prezantimin si grup artistësh që jetojnë në vende të ndryshme të botës, për të treguar që aq sa i ndajnë stilet që aplikojnë në punët e tyre po aq i bashkon arti i pikturës dhe identiteti i përbashkët. Punimi i secilit në këtë Bienale arti është jo vetëm prezantues talenti, teknike por edhe paraqitje vlerash e kulture. Ky udhëtim që nuk ka një renditje të caktuar, por mund të nisët nga secila punë e secilit autor është shprehëse e një identiteti të fortë. Udhëtimin tim e nisa nga "The Guardians" i kosovarit Driton Haxhredini për të kaluar te "Tombsstone 1878" e Ervin Hatibit, pastaj te "Ikona" e Dalip Kryeziut ng Kosova, te "Mediterran Corner" i



6 artistë shqiptarë në Biennalen e Pragës

Mes tyre edhe dy artistë shqiptarë që jetojnë në Itali, Artan Shabani e Alfred Mirashi - Milot



Nga lart
Alfred Marashi -
Milot: "Mediterranena
Corner" diptik,
80x100 cm, 2008
dhe Artan Shabani
'Homo Balkanicus'
vaj, 145x110 cm 2008



Duke shfletuar historinë e shkurtër, por të rëndësishme të Bienales se Prages vëme re se në Edicionin e saj të 2007-ës ekzistonte një ekspozim me titull "nga Kosova në Stalingrad" - një udhëtim në gjithë Europën qendrore dhe ish-URSS për të sjellë e mbledhur kujtime kolektive e histori sociale.

Ky fakt premtion vëmendjen nga ekspertët e artit ndaj krijimeve të artistë tanë, të cilët urojmë të mirëpreiten dhe të vlerësohen

Alfred Milot Mirashi, 'Hot summer' i Alkan Nallbanit dhe në fund, te një punim nga cikli i famshëm "Homo Balkanicus" i Artan Shabanit. Ky kalim thjesht informues e jo përshkruar apo komentues mbasi këto vepra megjithëse të njohura janë tashmë në një skenë tjetër, në atë ndërkombëtare e bashkëkohore dhe presin komentin e kritikës.

Këta janë artistët që do të na prezantojnë në Bienalen e Pragës. Janë krijues relativisht të rinj në moshë, por të "pjekur" në eksperiencë jete e pune. Janë ata që në Shqipëri kanë "themelet" e vendeve të huaja kanë "muret" e shtëpisë së tyre. Janë krijuesit që për strehë të tyre kanë mbarë botën. Ata që na përfaqësojnë e promovojnë me artin e kulturën tonë ende pak të njohur nga bota.

Këta gjashtë artistë janë dëshmi e një prej realiteteve krijuese të artistëve bashkëkohore shqiptarë. Këtë vit Bienalja e Pragës i rezervoi këtyre talenteve shqiptarë e kosovarë këtë vëmendje e mundësi, por interesi i saj nuk është i rastësishëm. Duke shfletuar historinë e shkurtër, por të rëndësishme të Bienales se Prages vëme re se në Edicionin e saj të vitit 2007 ekzistonte një ekspozim me titull "nga Kosova në Stalingrad" - një udhëtim në gjithë Europën qendrore dhe ish-URSS për të sjellë e mbledhur kujtime kolektive e histori sociale. Ky fakt premtion vëmendjen nga ekspertët e artit për krijimet e artistëve tanë, të cilët urojmë të mirëpreiten, të vlerësohen.

Venera Kastrati në Romë në ekspozitën "Mediterranean"

Ka ekspozuar në Romë në një ekspozitë të përbashkët të quajtur "Mediterranean", në ditët 2-5 prill, viedo-artistja dhe instalacionistja shqiptare Venera Kastrati. Në ekspozitën e mbajtur në Palazzo Rospigliosi kanë marrë pjesë edhe artistë nga të tjera vende të Mesdheut që synonin të sillnin në të pjesë të një zone kaq komplekse e kaq të pasur kulturalisht. Artistja shqiptare ka marrë pjesë me disa intalacione si "Damn the very first emigrant", "White doll", "The woman produces the man, the man will kill her", të cilat janë veprat që përfaqësojnë më mirë hulumtimin artistik të artistes ku spikat studimi i feminitetit në marrëdhënie me dhunën dhe gjendja e migruesit.

Në foto artistja dhe dy nga punimet
Lart: White doll
Poshtë: Damn the very first emigrant



coop voce
La telefonia Coop

"NO FRONTIERE COOP"
PËR T'U NDIJER MË PRANË FAMILJES DUKE KURSYER!



Telefono në numra celulari dhe të telefonisë fikse me vetëm **18** qindarka për minutë.

Kërko informacion në pikat e shitjes **coop** dhe **ipercoop** që ke më pranë!

Tarifimi parashikon impuls përgjigjeje prej 15 qindarkash dhe parapaguhet çdo 60 sekonda. Tarifa e lehtësuar për trafikun ndërkombëtar të kryer është e vlefshme deri në arritjen e kufirit prej 550 minutave çdo 30 ditë. Me kapërcimin e këtij kufiri do të aplikohet tarifa e parashikuar

nga plani yt tarifar Coop Voce për thirrjet ndërkombëtare. Opsioni përtërihet falas dhe automatikisht çdo 30 ditë nga aktivizimi. Minutat të trafikut që nuk janë përdorur nuk do të mund t'i shtohen kufirit të muajit pasardhës. Aktivizimi i ofertës do të të konfirmohet nga një SMS brenda 48 orëve nga kërkesa.

**Convenienza
e trasparenza**



**Të kalosh në CoopVoce
për të folur me tarifa
të volitshme është FALAS!**

**Paraqit këtë bonus në një
pikë shitjeje COOP.
Vlen një Aktivizim falas.**

Është i vlefshëm për të marrë dhuratë një SIM CoopVoce që shitet më vete, deri më 30 Qershor 2009. Mund të përdoret vetëm një herë nga çdo klient.

188 Shërbim Asistence Klientëve

Falas nga celularët CoopVoce

Kushtet e Përgjithshme të kontratës i gjen në pikat e shitjes Coop dhe ne faqet internet **www.coopvoce.it**

abonohu në

Bota shqiptare

GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e mimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në Itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetri zë në gjuhën shqipe në shtypin italian

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE
apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Më ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.



BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

Më 18 Prill 2009, në qytetin e Chierit, pranë Torinos, në Itali, u zhvillua ceremonia e dhënies së çmimeve letrare në kuadër të edicionit të 9-të të konkursit "Principe Giorgio Castriota Skanderbeg". Konkursi letrar, emri i të cilit i dedikohet heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, organizohet nga shoqata Vatra Arbëreshe e Chierit.

Çmimet ju jepen krijimeve të reja më të mira letrare në gjuhën Arbërishte, si edhe krijimeve më të mira të nxënësve me origjinë Arbëreshe që studiojnë në shkollat Italgjane. Duke filluar nga ky edicion, një seksion i posaçëm i konkursit i rezervohet edhe krijimeve të reja poetike të shkruara në Shqipëri letrare.

Në bashkëpunim me Federatën e Shoqatave Shqiptare, Italo-Shqiptare dhe Arbëreshe të Piemontit, të përfaqësuar në ceremoni nga zv. presidenti i saj Benko Gjata, këtë herë juria e

konkursit vlerësoi me çmim edhe krijime poetike të autorëve Shqiptarë.

Juria e konkursit kryesohej nga prof. Italo Fortino, titullar i katedrës së gjuhës dhe letërsisë Shqipe pranë Universitetit të Napolit. Anëtarë të saj ishin edhe Visar Zhiti, Atashe Kulturor pranë Ambasadës së Shqipërisë në Itali, Eduard Soppi, kryetar i shoqatës 'Nënë Tereza' të Astit, Annunziata Delli Santi, eksperte e gjuhësisë pranë Sportelit Gjuhësor të Rajonit të Bazilikatës si edhe poeti Arbëresh Tommaso Campera, përgjegjës i Departamentit të Kulturës pranë shoqatës "Vatra Arbëreshe".

Fitues të edicionit të nëntë të konkursit, në seksionin e krijimeve në Arbërisht, u shpallën kantautori Francesco Scaravaglione, nga Pavia, si edhe nxënësja Katia Forte, në seksionin e autorëve të rinj. Në seksionin e dedikuar Shqipes letrare, për poezinë më të mirë të pabotuar fituese u shpall shkrimtarja dhe studjuesja vlonjate Vilhelme Vranari; ndërsa çmimi i posaçëm i jurisë për kontributin e dhënë në lëvrimin e letrave Shqipe ju dha autores dhe përkthyeses Valbona Jakova.

Ceremonia u shoqërua me një spektakël i titulluar "La sposa di Scanderbeg" ("Nusja e Skënderbeut") i paraqitur nga trupa artistike "Centro Mediterraneo delle Arti". Spektakli, me këngë dhe muzikë të traditës më të mirë Arbëreshe të luajtur live, rrëfen fazat e ndryshme të emigrimit Arbëresh në Itali.



Çmimi Skanderbeg

Zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve të edicionit IX të konkursit letrar.

U shpallën fitues Francesco Scaravaglione për seksionin e arbërishtes, Katia Forte, për autorët e rinj, dhe Vilhelme Vranari, për seksionin e shqipes letrare. Çmim i veçantë për përkthyesen Valbona Jakova


"Nëse qëndroj shumë gjatë do të qëndroj përjetë", ekspozita e fundit e Leonard Sherifit

Titulohet "If I stay too long I'll stay forever" ekspozita më e fundit e artistit të ri shqiptar Leonard Sherifi. Mbahet në Genova nga data 16 prill deri në 8 maj, pranë galerisë Arte Studio in Porta San Giovanni il vecchio. I sapodiplomuar në fakultetin e arteve të bukura të universitetit të Genovas, 25-vjeçari edhe pse në moshë kaq të re ka pas një sërë ekspozitash në vende të ndryshme të Italisë, dhe në evente ndërkombëtare. I lindur në Berat në 1984 djaloshti shqiptar ka studiuar art në Genova, ku edhe aktualisht jeton, duke u specializuar në pikturë. Tematikat

e tij shkojnë nga hapësirat urbane të interpretuara në detaje deri në studimet antropomorfike që lënë shumë shkas për interpretim të botës së brendshme të artistit. Ngjyra të tunxhta, e të forta, forma

të rrumbullakëta të tripërmasuara me mjeshtëri, e teknika dritë-hijesh që komunikojnë më shumë se sa thjeshtë formën dhe hapësirën trupore,

mbushin piktura të sipërfaqeve të mëdha që rrisin përgjegjësinë e autorit. Spikasin teknika të pjekura që dëshmojnë një përgatitje të gjatë e të artikulluar përmes studimesh shumëvjeçare dhe cilësore. Leonard Sherifi i përket kontingjentit të studentëve shqiptarë të formuar në universitetet italiane me profesionalizëm të lartë në drejtimet artistike, që me siguri do t'i shtohet listës së artistëve shqiptarë me aktivitet ndërkombëtar.






FJALË MES DY BRIGJEVE

Nga 23 deri më 26 prill, Agimi i Riminit ka mbledhur qindra shqiptarë dhe italianë, në një festë ndëretnike.

Në bashkëpunim me komunën e Bellarias (të provincës së Riminit), dhe shoqata e ente të tjera, shoqata shqiptare Agimi e Riminit ka organizuar edhe këtë vit një festë të madhe për shqiptarë e italianë. Për katër të mërkurat e prillit, Agimi bashkë me shoqatën kulturore "L'Uva Grisa" kanë organizuar kurse për mësimin e kërcimeve karakteristike shqiptare. 23 prilli i është kushtuar brezit të ri dhe integritetit të tij në shkollën italiane. Ndërsa 25 dhe 26 prilli, ishin ditët me më shumë veprimtari. Manifestim në kujtim të të rënëve në luftë, konferenca, takim me poetin Visar Zhiti, e në fund një festë me këngë e valle. Nuk munguan pjatancat karakteristike si byrekë, bakllava të gatuar me mjeshtëri nga gratë shqiptare e të pëlqyera nga të gjithë, të mëdhenj e të vegjël.



Gjatë ditëve të ndryshme, në veprimtari morën pjesë me qindra qytetarë shqiptarë e italianë, dhe mes tyre edhe Kryebashkiaku i Bellarias, Gianni Scienna, ish ambasadori italian në Shqipëri Mario Bova, sekretari i përgjithshëm i Universiteti "Zonja e Këshillit të Mirë" Edmond Hajdëri, poeti Visar Zhiti, drejtuesi i katedrës së gjuhës shqipe në universitetin "La Sapienza" të Romës Elio Miracco e shumë të tjerë.



Shqiptari i Italisë: Një libër me kujtime të një polici kufiri. Është diçka e rrallë edhe nga ana editoriale.

Nicola Montano: Ideja për të shkruar këtë libër më lindi kur dola në pension. Në një farë pike pata dëshirë të shikoj prapa gjithë ç'kisha bërë deri në atë moment dhe vendosa të hidhja në letër atë pjesë të jetës sime që ka të bëjë me portin e Barit. Dhe kështu përfundova duke folur për klandestinët, ndër të cilët edhe për shqiptarët.

Çfarë synonit t'i shtonit fjalosjes së madhe që bëhet rreth klandestinëve në Itali sot?

Para së gjithash, doja të thosha se klandestinët janë njerëz. Dhe natyrisht meritojnë respekt. Kanë të kaluarën e vet, jetën e vet që meriton të respektohet. Ideja e librit më lindi edhe duke dëgjuar aq shpesh lajmet ku flitet për klandestinët mirëpo flitet sikur të ishin vetëm numra, e jo persona. Për shembull pak ditë më parë u fol për disa të vdekur në det gjatë transportimit të klandestinëve. Ndjesia ime si para pak ditësh edhe gjithmonë ishte se po raportohej një shifër e çfarëdoshme sikur të mos kishe të bëje me njerëz. Ndërkohë që këta klandestinë janë njerëz. Shpesh flitet për klandestinët dhe kriminalitetin, këto dy gjëra përfundojnë si sinonime. Klandestini është një njeri që ka dëshirë të shkojë në një vend tjetër. Është një njeri që ka të drejtë të kërkojë një jetë më të mirë në një vend tjetër. Këtu sa herë që flitet për klan-

SHQIPËRIA VENDI PËRBALLË

Pas premierave të suksesshme në Romë, Tiranë e Prishtinë, dhe shfaqjes në televizionin kombëtar Klan, filmi dokumentar "Shqipëria vendi përballë" i institutit Luce po shfaqet qyteteve të Italisë në veprimtari të ndryshme të organizuara nga ente apo shoqata. Në muajin prill u shfaq në Bari në kuadrin e "Fiera del Levante".

Në muajin maj filmi do të shfaqet në Rieti e Firenze. Shoqata studentore ASUF e Firenzës ka organizuar shfaqjen e dokumentarit ditën e enjte më 7 maj, në orën 20.00, në sallën e kinemasë në Shtëpinë e Studentit "Piero Calamandrei" (Viale G.B. Morgagni 51 - Firenze).

Ndërsa në Rieti është shoqata Iliria që organizon shfaqjen e filmit të shtunën më 2 maj, në orën 18.30, në sallën e konferencave të Hotelit Serena (Via dei Salici, 46 - Rieti).

Në të dyja shfaqjet do të jetë i pranishëm autori i filmit, gazetari Roland Sejko. Filmi do të shfaqet gjithashtu për herë të parë në televizionin italian, në kanalën satelitor History Channel, më 12 maj në orën 22.00. History Channel ka programuar edhe ritransmetime të tjera gjatë muajve të ardhshëm.



NICOLA MONTANO

“Unë, polic kufiri, e di ç'do të thotë të jesh emigrant”

Intervistë me Nicola Montanon, ish polic i kufirit në portin e Barit, që mes përvojave të tij të shumta ka përjetuar edhe tmërritjen e anijes "Vlora" në Bari në gusht 1991. Përjetimet i ka hedhur në një libër, "Ladri di stelle" i sapodalë në shtyp ku tregon histori klandestinësh, ngjarje të dhimbshme e njerëzore që përbëjnë përditshmërinë e një polici kufiri.

destinët flitet për kriminalitet., por kriminaliteti nuk ka kombësi. Krimineli është kriminel mbi kombësinë që mund të ketë.

Por këto aspekte lihen gjithmonë pas dore nga mediat...

Po këto aspekte lihen pas dore. Kur flitet për klandestinët flitet vetëm për kriminalitet. Natyrisht që ka edhe kriminelë mes tyre. Por mediat italiane duhet të kenë parasysh se këta klandestinë janë njerëz që kanë lënë familjet e tyre, vendin e tyre, jetën e tyre të mëparshme për të filluar një tjetër në vendin tonë. Natyrisht ligjet duhen respektuar por duhet gjetur mënyra se si të respektohen këto rregulla. Pas 40 vjet pune në polici, kam luftuar kriminalitetin, dhe më ka ndodhur të kem të bëj edhe me klandestinë. Por kur këta mbërrijnë në Itali janë vetëm njerëz dhe asgjë më shumë. Unë kur kam qenë i ri kam qenë emigrant në Gjermani dhe i kam kaluar këto përvoja mbi lëkurën time dhe e di se ç'do të thotë kur të trajtojnë në këtë lloj mënyre. Në thelb, problemi varet edhe nga paaftësia e shtetit italian në përballjen me problemin e emigrantëve klandestinë.

Si ka mundësi që pas pothuaj 20 vjetësh shteti italian mbetet ende i papërgatitur ndaj këtij problemi?

Jam dakord me pohimin tuaj, shteti italian mbetet i papërgatitur. Mungon një politikë koherente. Shteti nuk shqetësohet për t'iu përgjigjur nevojave të vërteta të vendit. Nëse industria kërkon krahë pune,

kjo do të thotë se duhen marrë këta njerëz nga jashtë. Mirëpo këta njerëz nuk janë vetëm një palë krahë, që i përdor vetëm për punë dhe pastaj mund edhe t'i hedhësh tutje, janë njerëz, me tru, me një personalitet të vetin, që kanë nevoja si edhe ne të tjerët. Kështu mendoj që Italia duhet të ndryshojë

mënyrën e përballjes me këta imigrantë, si edhe në përkrahjen e shumë italianëve që kanë nevojë për ndihmën e shtetit.

Pra është faji i mungesës së një shteti social, apo është edhe fakti që Italia nuk është ende e mësuar me shumëkulturesinë?

Po edhe kjo është. Italianët nuk janë të mësuar me këtë shoqëri të re shumë-etnike e shumëkulturore sepse italianët deri para pak kohësh ishin vetë emigrantë e madje pjesërisht duhet thënë se mbeten ende të tillë, veçanërisht për sa i përket jugut të Italisë. Të rinjtë e jugut shkojnë të gjithë drejt veriut apo drejt Evropës. Di me siguri se janë të paktën 270 mijë të tillë në vit që largohen nga toka e tyre për të emigruar. Vende si Irlanda apo si Spanja kishin të njëjtat probleme por me zbatimin e politikave të duhura kanë arritur ta reduktojnë këtë problem e madje edhe ta asgjësojnë pothuaj atë. Unë sot jam pothuaj 60 vjeç, dhe mund t'ju them me siguri se për sa kujtoj unë, asgjë nuk ka ndryshuar.

Pra është një problem shumë i thellë?

Po, unë kur kam qenë polic në veri, më thërrisnin herë pas here me epitete të ndryshme, fyese. Herën e parë mund ta merrje lehtë, pastaj ndodhte që të krijoheshin probleme. Sipas meje, njeriu duhet të trajtohet siç thotë Deklarata e të drejtave të njeriut. Meqenëse ne e pranojmë sepse Italia e ka nënshkruar, duhet edhe ta zbatojmë. Edhe pse ka shumë probleme me vetë italianët, ata që vijnë në Itali duhet të priten me dinjitet. Nuk është e vërtetë që të gjithë rumunët sot, apo të gjithë shqiptarët dje, janë kriminelë. Këtë e dinë të gjithë. Pikërisht nga përvoja ime si polic mund të them se më kujtohet që në '92-shin, apo '93-shin shikoja shumë shqiptarë, ndër të cilët nuk mungonin trafikuesit e drogës e të prostitucionit, por shumica e tyre ishin familje që ktheheshin në shtëpi. Ishin njerëz që në Itali jetonin dhe kontribuonin edhe në mirëqenien e Italisë.

Çfarë thuhej mes kolegësh, ndërsa shqiptarët fillonin të zbarkonin në vitin '91?

Mbetëm të shushatur, nga gjithë ajo masë njerëzish që papritur erdhën në brigjet tona. Nuk e njihnim akoma Shqipërinë, por po fillonim ta njihnim. Njerëzit na tregonin për të. Me ndonjë përjashtim pati mirëkuptim ndaj tyre.

Si ju dukeshin shqiptarët, këta të panjohur?

Ajo që na çudiste tej mase, vijon në faqen 22

NICOLA MONTANO

"UNË, POLIC KUFIRI, EDIÇ DO TË THOTE TE JESH EMIGRANT"



nga Nicola Montano

Përkthyer nga libri "Ladri di stelle"
"Shqiptari i Italisë" falenderon autorin dhe
botuesin për lejinin e botimit

Shokët e zyrës ishin të gjithë të zënë me kontrollet e pasagjerëve të mbërritur nga Greqia dhe nga Jugosllavia. Pashë përreth dhe vura re se ndihmës agjenti Giuseppe Laforgia ishte i lirë deri në ora 1.

"Do të vish me mua në mol të presim shqiptarët?" i thashë.

"Pa tjetër" mu përgjigj

Hipëm në një fiat Ritmo me targë mbuluese, e ngijsa unë. Vapa e lagësht e padurueshme, robat na ngjiteshin në trup. Kur mbërritëm në mol, hipa mbi digë për të parë por nuk shquhej ende asgjë, për shkak të mjegullës së dendur. Papritur mu duk se pashë një hije në mes të detit. Ishte mjaft afër. Ndihej zhurma e motorëve. Ndërsa anijet afroreshin, arrija të shquaja më mirë.

Shtanga në vend, Pasquale kishte të drejtë: ishte e pamundur të thoshe sa ishin njerëzit në bordin e asaj anijeje. Njerëzit kishin zënë gjithçka. Verige njerëzish dukeshin sit ë varur nëpër seren. Mbata duke e vështruar gojëhapur, ishte një shfaqje e jashtëzakonshme, e papërsëritshme për mua. Nuk mund të imagjinohej një gjë e tillë.

Anija ushtarake italiane pengonte parjen e plotë të asaj skene. Vlora, lëkundej, nga një anë në tjetrën, lundronte ngadalë por me vendosmëri drejt hyrjes së portit. Anija Euro, ishte aty, përpigëj të ndiqte urdhrat e mara: ajo anije shqiptare nuk duhej të hynte në port. Komandanti kishte marrë urdhrë të bindte shqiptarët se nuk duhet të hynin në port. Mundohej ta pengonte duke i lundruar "Vlorës" përreth, dukej sikur vallëzonte rreth saj. Motovedetat qëndronin në distancë sigurie për të mos penguar manovrat.

Komandanti i "Vlorës", me sa dukej e dinte, se "Euro" nuk mund t'i pengonte hyrjen në port. Po të mos hapte zjarr apo ta çante me shpor. Po këto ishin mundësitë që anija ushtarake italiane kishte për ta ndaluar "Vlorën". Po o Zot, si mund të qëllonte ajo anije? Ata njerëz të pambrojtur?

Pasi i telefonova sallës operative, në radio dëgjova komandantin e kapitanerisë që fliste me kapitenin e "Vlorës".

"Kapiten qeveria italiane ka vendosur t'ju mohojë hyrjen në portin e Barit. Duhet të ktheheni në Shqipëri".

"Nuk mund të më mohoni hyrjen. Ju duhet të dini se këtu ka njerëz pa ndjenja nga uria dhe nga etja. Ka fëmijë, gra shtatzëna dhe pleq që kanë nevojë për ndihmë mjekësore. Nëse nuk u jepet ujë, për pak orë do të fillojnë të vdesin. Në bord është një i plagosur rëndë, që do të vdesë nga humbja e gjakut".

"Kapiten po ju përsëris se në Itali nuk mund të hyni. Duhet të ktheheni mbrapsht. Duhet të ktheheni në Shqipëri".

"Nuk mund të kthehem në Shqipëri në këto kushte. Ka probleme me motorët. Nuk mund të bëj shmangie. Ekuipazhi është i sflitur, motorët kanë nevojë për riparim. Këtu është një i plagosur rëndë. Njerëzit kanë etje, kanë uri. Ka fëmijë dhe gra shtatzëna që kanë nevojë për mjekim".

vijon nga faqja 21

ishte mënyra e tyre e të veshurit, që ishte shumë e standardizuar, dhe për më tepër vishnin disa pantallona të gjera që ne kishim pasur 30 vjet përpara. Personalisht më dukeshin shumë të dobët, nuk e di nëse nuk hanin, por është e qartë se nuk ishin mbipeshë. Por ishin shumë të shkathët e të fortë. Më kujtohet kur zbarkoi Vlora, shikoja fëmijët shqiptarë që mbanin në krah fëmijë më të mëdhenj se vetja dhe ia dilnin t'i mbanin. Nuk besoj se fëmijët tanë do të mund të bënin të tilla gjëra. Ndoshta është çështje mbijetese.

Pastaj fillon faza e kriminalitetit shqiptar dhe albanofobia pushton mediat. Po mes policëve çfarë mendohej për këtë "racë kriminelësh"?

Mediat kanë ndikuar shumë në ndërtimin e këtij stereotipi. Ka pasur një bombardim disa-vjeçar me idenë se shqiptarët ishin kriminelë. Unë kam arrestuar shumë shqiptarë, por ndërsa arrestonim një prej tyre, kishim përballë shumë të tjerë që kalonin kufirin dhe që ishin njerëz të mirë që punonin. Kishte shumë shqiptarë që ishin bërë kriminelë, ndoshta ishin të tillë edhe në Shqipëri. Por pasojat e këtij problemi i kanë vuajtur edhe ata shqiptarë që nuk bënin pjesë në këtë grup.

Po tani, si mendoni ç'mendim mbizotëron për shqiptarët?

Tani është radha e rumunëve. Shqiptarë tani janë bërë rumunët. Bindja më e përhapur është se shqiptarët tashmë janë bërë italianë. Janë mësuar të jetojnë në mënyrë italiane, veçanërisht të rinjtë, që kanë zakonet e italianëve, vishen si italianët.

Vitin e kaluar shkova në Durrës dhe në Tiranë. Tashmë mund të thuhet se nuk ka ndryshim midis dy brigjeve. Dikur shikoja një shqiptar dhe e dalloje, sot shqiptarët nuk dallohen më. Shqiptarët që jetojnë sot në Itali janë bërë italianë.

Ju keni qenë emigrant në Gjermani në vitet '60, kur ishit shumë i ri. Përvoja që keni pasur me shqiptarët ju ka kujtuar në ndonjë lloj mënyre përvojën tuaj personale në Gjermani, kur ju kishit rolin e shqiptarëve?

Ka një paralelizëm. Qëllimi është të punuarit. Përmirësimi i jetës së vet. Unë shkova në gjermani për të arritur pavarësinë ekonomike dhe për të ndihmuar familjen time që ishte në varfëri. Përndryshe nuk do të kisha ikur. Nuk besoj se njerëzit e lënë shtëpinë e vet kaq lehtë në mos për arsye turizmi, ndodh vetëm për të përmirësuar kushtet e jetesës.

Si ishte përvoja juaj në Gjermani, ndërkohë që deri para pak kohësh gjermanët i përkufizonin italianët në mënyrë fyese "italiener"...

Jo, fjala e përdorur më shumë ishte "italiener Scheisse", merda italiana.... Nuk ishte e thjeshtë sepse pata shumë probleme, por nga ana tjetër ndesha edhe gjermanë shumë të sjellshëm. Kisha disa zonja që kur unë kthehesha në shtëpi nga puna, me jepnin një pjatë supë gati. është një gjë e përbashkët për të gjithë vendet. Ka njerëz që janë bujarë dhe dashamirës, ka të tjerë që janë më të mbyllur dhe antipatikë. Për fat të keq, në këtë aspekt, nuk e mendojmë të gjithë njësoj.

Si ka mundësi që një popull si italianët që kanë qenë viktimë e një racizmi të theksuar kudo në Evropë deri para tridhjetë vjetësh, të arrijnë të shprehin gjithë këtë urrejtje ksenofobie ndaj rumunëve apo shqiptarëve para 10 vjetësh?

Lexova librin e Gianantonio Stellës "Quando gli albanesi eravamo noi", dhe aty shfaqet qartë sa kanë vuajtur italianët jashtë shtetit. Dhe për mendimin tim, ajo që ata kanë pësuar është diçka shumë herë më e ashpër se ajo që kanë pësuar shqiptarët në Itali. Nuk besoj se ekziston një urrejtje e përgjithshme për shqiptarët apo për rumunët në Itali sot. Unë për shembull kam fqinj një djalë shqiptar që është një punëtor i jashtëzakonshëm dhe të gjithë e respektojmë. Ai jeton në Itali prej 20 vjetësh, zgjohet në mëngjes në orën 5, e kthehet në shtëpi në orën 8. Ç'mund të presësh më shumë nga një njeri i ndershëm. Shumica e italianëve nuk janë racistë, por ka një pakicë që është e tillë.

Bisedoi Marjola Rukaj

Ato ditë apokaliptike të eksodit biblik të të rinjve shqiptarë që kapërcyen Adriatikun atë verë të nxehtë të '91 të largët, janë treguar e ritreguar shumë herë me ngjyrimet e panumërta emocionale, dhe vrullin e parrëfyeshëm të anktheve, pritmërive, e përjetimeve përvuajtëse të protagonistëve. Pikëpamja e atyre që i pritën deri tani ka qenë ndonjë raportim gazete përshkrues, e përmbledhës, shpesh herë në vija të trasha cinizmi e përgjithësimi. Për herë të parë mungesa plotësohet me dëshmitë e një prej protagonistëve të atyre ditëve, por që nuk ishte në bordin e atyre anijeve por në bankinën e portit ku ata do të zbarkonin.

VLORA MBËRRIN NË BARI

"Atëherë mund të ancoroni në det të hapur. Ne do t'ju sjellim ujë dhe ushqime. Do t'ju sjellim ndihmë mjekësore për të plagosurit".

"Jo nuk mundem, jam i detyruar të hyj në port".

U ktheva në mol dhe pashë "Vlorën" që po bënte manovër për të hyrë në port ngadalë, por e vendosur. Fjalët e komandantit të Kapitanerisë, kishin bërë një vrimë në ujë. Edhe manovrat e fregatës "Euro", që po përpiqej të pengonte hyrjen e "Vlorës" në port kishin qenë të kota. Kapiteni i "Euros", nuk und të mendonte dhe me të drejtë nuk çau shpor "Vlorën". Po të kishte vepruar kështu me siguri do të kishte shkaktuar një nga katastrofat më të mëdha të ndodhura ndonjëherë në det. Për fat të mirë moti ishte i mirë, sikur fuqinë e mbinatyrshme të ruanin ata mijëra njerëz të ngjeshur ngado në atë anije.

Ndodhësia pak metra nga hyrja e portit. Dhe shikoja gjithçka. Shqiptarët po festonin. Ia kishin dalë mbanë. Thirrmat e gëzimit ishin të panumërta, njerëzit qeshnin nga lumturia, gëzimi se kishin arritur në Itali, në tokën e lirisë dhe të mirëqenies.

(...)

Një djalosh shqiptar që kishte kuptuar gjithçka me sa duket, u zhyt në ujërat e portit, dhe pas pak çastesh edhe shumë të tjerë ndoqën shembullin e tij. Ishte ora, 10 - 10 e gjysmë dhe përpjekja e shqiptarëve për të "pushtuar" Barin kishte filluar.

Unë shikoja nga moli atë shfaqje të paparë.

"Laforgia, tani do t'i sjellim këtu. Të përpiqemi



Anija Vlorë në det të hapur para mbërritjes në Bari fotografuar nga rojet kufitare italiane

”

Mes mesazheve njëri më la mbresë të veçantë. Ishte i kapitanerisë. I drejtohej prokurorisë së republikës, dhe policisë detare. Ishte komunikimi i një krimi. Informonte se në mëngjes kishte mbërritur në port anija "Vlorë", numër amze 31 nga Durrësi T.s. 18649 me rreth 10 mijë refugjatë dhe që në atë moment nuk dihej cili ishte kapiteni. Hipotezohej dhunimi i nenit 1231 të kodit të lundrimit sepse kishte transportuar pasagjerë më shumë se ç'i lejohej

**NICOLA
MONTANO
LADRI DI
STELLE
Medusa edi-
zioni, 2009
200 faqe, €
15,00
EAN
9788876981
814**



t'i mbledhim në këtë hapësirë këtu. Tregova një zonë të bankinës. Aty ishim vetëm unë dhe kolegu im Laforgia.

Motovedetat që deri në atë moment kishin shoqëruar dy anijet, na hynë shumë në punë. I merrnin njerëzit nga deti, dhe na i sillnin në platformë apo pranë saj. Unë dhe Laforgia u lagëm komplet për t'i ndihmuar që të hipnin në platformë. Ende më kujtohet buzëqeshja e atyre shqiptarëve të shtrirë në mol, të raskapitur e të uritur. Kërkonin ujë. Ishin të lumtur dhe thërritnin "Italia, Italia". Më dukej vetja sikur isha në një stadium ku luante kombëtarja italiane. Pas pak minutash unë dhe Laforgia u pamë në sy të shqetësuar. Nuk mund ta përballonim vetëm atë situatë. Ishin me mijëra shqiptarët që kishin mbërritur aty.

vijon nga faqja 23

VLORA MBËRRIN NË BARI

(...)

Shqiptarët filluan të pyesnin veten se ç'do të bënim tani me ta. Mora vesh se jashtë portit kishin mbërritur autobusë, të AMTAB-it, ndërmarjes të transporteve urbane, të Barit, që do të ngarkonin shqiptarët dhe do t'i transportonin në stadiumin Vittoria, ishte gusht, agjentët e policisë ishin të paktë, pushimet ishin në mes të tyre, shumë dyqane ishin të mbyllura, qyteti ishte zhytur në stinën e verës. Nuk kishte zgjidhje tjetër përveç thirrjes në ndihmë edhe të mbrojtjes civile.

Shqiptarët mbërrinin në platformë dhe shtriheshin të lagur në të. Gjithë bankina ishte e mbushur me njerëz. Vapa mbizotëronte dhe dielli kishte fituar mbi mjegullën. Vapa ishte e padurueshme.

(...)


Mbërritën dhjetëra autobusë. Duhej të hipnim aty shqiptarët. Filluan t'i çonim drejt stadiumit, por shqiptarët ishin të pafundmë, e madje shtoheshin sepse të tjerë po mbërrinin nga anija që ishte ankoruar. Nga të bërtiturit në atë gjullurdi, më ishte ngjirur zëri. Pluhuri i qymyrit që kisha thithur më pengonte të merrja frymë. Një karabinier në një motovedetë të ankoruara në mol, më pa dhe më afroi për të më dhënë ujë. E piva me shpejtësi si hajdut. Ata njerëz kishin më shumë nevojë se unë.

Ndërkohë erdhi një autobot me ujë të pijshëm. Kishte disa rubinete në pjesën e pasme. Kur shqiptarët e vunë re, u turrën të gjithë për të pirë. Ata që ishin më të fortë arrinin të pinin, ata që nuk mundeshin nuk arrinin të pinin, sepse nuk luftonin dot, me atë turmë të jashtëzakonshme njerëzish që shtynin njëri-tjetrin për të mbërritur tek uji. Disa prej tyre humbnin ndjenjat, binin përdhë. Filluan të vinin ambulancat. Kishte një mishmash të jashtëzakonshëm. Telekamerat dhe aparatet fotografikë të reporterëve fiksonin gjithçka. Nga Roma mbërritën kolegët e Reparit të Lëvizshëm të gjithë të rinj dhe shumë impulsivë. Ishin të armatosur me shkop gome. Deri në ato momente unë dhe të tjerët kishim arritur të kontrollonim mijëra shqiptarët pa pasur nevojë për dhunë. Unë përpiqesha të ndërhyja nëpërmjet disa prej tyre që flisnin italisht, që të na ndihmonin të mbanin një farë rregulli. Gjërat deri në atë moment kishin shkuar mirë. Autobusët ngarkoheshin me njerëz sipas një rendi të caktuar duke respektuar lidhjet familjare dhe miqësore. Nëse

dikush thoshte se në një autobus të caktuar ishte i biri, apo e shoqja, i vëllai apo ndonjë shok, edhe ai hipte në të njëjtin autobus. Nëse nuk arrinte të hynte, zbriste ndonjë vullnetar. Kurse agjentët e ardhur nga Roma, ndoshta sepse nuk kishin pasur mundësi të vëllazëroheshin me shqiptarët, si ne, nuk ishin aspak delikatë, dhe disa prej tyre filluan të përdornin shkopat e gomës. U nevríkosa shumë. I qortova ashpër: nuk kishte nevojë për këtë, të paktën deri në ato momente.

Papritur pashë të vinin grupe fëmijësh me mbathje që buzëqeshnin. Ishin të djersitur, të pistë nga pluhuri i zi dhe të uritur. Vura re se solidariteti ndërmjet tyre ishte më i fortë se ai mes të rriturve. Shumë prej tyre mbanin në krahë të tjerë fëmijë të rraskapitur dhe pa ndjenja. Të topitur nga dielli, nga i nxehti i gurëve të molit. Ishin të zbathur, dhe ecnin në majë të gishtave sepse toka ishte përvëluese. Ishin shumë të dobët, kishin sy të kaltër dhe flokë të shkurtër. Vështrimet e tyre më bënë përshtypje. Rrezikonin të viheshin përpara nga të rriturit që vraponin drejtë iluzionit të lirisë. Drejt përrallës së mirëqenies të parë në televizion. Për një çast ndenja duke i vështruar. I pashë të ndalonin pranë autobotit të mbushur me ujë të pijshëm. Shikonin por nuk kishin guxim të afroheshin. Me siguri do të shtypeshin nga turma e njerëzve, nga etja dhe nga egoizmi i të rriturve.

Pastaj pashë të vinin edhe të tjerë ishin, gjashtë apo shtatë, e pastaj u bënë 10 apo 15. Një prej tyre, rreth 10 vjeç, me një sforcim të jashtëzakonshëm, mbante në krah një tjetër më të madh se veten, që kishte humbur ndjenjat. Shikoja ata fëmijë dhe mendoja dy fëmijët e mi. Kishin të njëjtën moshë. Kuptova se mund t'i ndihmoja. I mblodha rreth vetes dhe i shpura tek autoboti. U afrova dhe shtyva atë turmë njerëzish të dëshpëruar që po shuante etjen. Dikush ra përtokë. Arrita të zija dy apo tre rubinete. I ftova fëmijët të pinin. Ndenja aty për shumë kohë duke ndihmuar fëmijët, gratë e pleqtë që të pinin. Përfitoi edhe



Anija Vlora fotografuar nga Fregata Euro e cila deri në çastin e fundur është përpjekur të mos e lejojë të hyjë në portin e Barit. NËSE do ta kishte prekur, Vlora e anuar nga pesha e madhe do të ishte përmbytur duke shkaktuar, siaps autorit të librit, një nga tragjeditë më të mëdha detare të ndodhura ndonjëherë. Fotoja botohet për herë të parë

një burrë që mbante një grua në krahë.

(...)

Kur arritëm tek anija Vlora, pashë tre kolegë të zyrës sime. Ishin aty që nga mëngjesi. Hipa në bord. Tashmë përveç ekuipazhit gjithë shqiptarët kishin zbritur. Binte një erë e rëndë e padureshme. Në çdo cep kishte fekale. Ishte si një nevojtoje e madhe. Stivat ishin plot me thasë sheqeri në të cilat shkruhej Cuba. Hymë në lokalet e ekuipazhit, edhe këtu e njëjta situatë. Të merrej fryma. Kufoma e një të riu ishte përtokë pranë urës së komandës. Kishte plagë të thella. Kishte vdekur nga humbja e gjakut.

(...)

Kapiteni i "Vlorës" një burrë babaxhan, na kërkoi ujë dhe ushqime për ekuipazhin. Nuk dinte të thoshte asgjë për vdekjen e djalit. Na dorëzoi një kallashnikov dhe shtatë pistoleta që disa ushtarakë shqiptarë kishin lënë para se të zbrisnin në tokë. E ftuam të na ndiqte në zyrë për ta marrë në pyetje. Armët i ngarkuam në makinë. Kapiteni u ul në sedilen e

pasme. Për të shkuar deri në zyrë na u desh shumë kohë. Na duhej të hapnim rrugën mes turmës së njerëzve në atë mol të ngushtë, dhe të gjatë pothuaj dy kilometra.

(...)

Në zyrë morëm në pyetje kapitenin. Quhej Halim Milaqi, ishte dyzet vjeç dhe ishte nga Durrësi. U përgjigj "jam shtetas shqiptar dhe flas mjaftueshëm italisht. Pra jam në gjendje tu përgjigjem pyetjeve."

"Mund të na sqaroni, çfarë ndodhi? Përse sollët në Bari mijëra njerëz me anijen e mallrave "Vlora"?"

"Para dy javësh me "Vlorën" dhe me gjithë ekuipazhin, prej 44 njerëzish, u ktheva nga Kuba, për të sjellë 10 mijë tonelata sheqer të prodhimit kuban. Dje në mëngjes, në shtatë shkurt 1991, ndërsa ishim në portin e Durrësit, u paraqitën përpara nesh mijëra bashkëkombës tanë. Donin të hipnin në anije dhe të udhëtonin drejt Italisë. Unë dhe ekuipazhi u munduam t'i ndalnim, por përpara numrit të madh të njerëzve që na shtynin e na kërcënonin, na u desh tu hapnim rrugë dhe të gjithë iu

turrën anijes. Në pasdite vonë kur anija ishte më se e mbushur me njerëz, nën kërcënime dhe nga ana e të gjithë atyre që kishin hipur na u desh të niseshim drejt Brindisit".

"Në ç'orë mbërritët në Brindisi?"

"Rreth orës katër të mëngjesit. Kapitaneria e portit të Brindisit, nuk na la të hynim në port, dhe na u desh të ndryshonim drejtim duke shkuar në Bari. Rreth orës nëntë mbërritëm në Bari. E theksoj se për të marrë rrugën drejt Brindisit, bashkëkombësit tanë na kanë kërcënuar për vdekje me armë në dorë mua dhe ekuipazhin tim. Ndër ta kishte edhe shumë policë shqiptarë të armatosur. Edhe ata na kërcënuan me armë. Gjatë lundrimit për tre herë patëm avari në motor dhe për fat arritëm t'i riparanim".

"Kur hytë në Bari përse nuk iu bindët urdhrat të komandantit të kapitanerisë së portit për të që nuk ju lejonte të hynit në port?"

"Sepse u sulmova nga bashkëkombësit e mi që detyronin të ankorohesha dhe të mbërrija në mol. Autoritetet italiane më thanë të ankorroja në det të hapur dhe të prisja ujë dhe ushqime por nuk më lejuan sepse bashkëkombësit e

mi nuk donin të ndalnim aty. Nën kërcënimin e armëve më detyruan të hyja në port. Kur hymë në port shumë prej tyre u hodhën në det, ku u gjetën nga motovedetat".

(...)

Shkova të kontrolloja postën. Mes mesazheve njëri më la mbresë të veçantë. Ishte i kapitanerisë. I drejtohej prokurorisë së republikës, dhe policisë detare. Ishte komunikimi i një krimi. Informonte se në mëngjes kishte mbërritur në port anija "Vlora", numër amze 31 nga Durrësi T.s. I 8649 me rreth 10 mijë refugjatë dhe që në atë moment nuk dihej cili ishte kapiteni. Hipotezohet dhunimi i nenit 1231 të kodit të lundrimit sepse kishte transportuar pasagjerë më shumë se ç'i lejohej, dhe sepse kishte thyer nenet e kodit penal 1100 dhe 650 pasi nuk iu bind ndalimit të hyrjes në port që i ishte transmetuar me radio me frekuencë ndërkombëtare dhe me urdhra të përcjella nga motovedetat e forcave të policisë. Kërkonin të shqyrtohej mundësia e sekustrimit të anijes.

Nicola Montano

"Ladri di Stelle", Medusa Edizioni



Një tezgë në treg për Johnin

Të marrësh iniciativën, të projektosh një sipërmarrje mund të mbetet vetëm një ëndërr nëse nuk keni mundësi të merrni një hua. Tani të hapësh një dyqan, të blesh mjetet, apo një furgon mund të bëhet nga kushtet që merr iniciativën të investojë, falë shërbimeve të mikrokredivë të PerMicro.

John-it, 33 vjeç, kenian, në Itali prej 3 vjetësh në kërkim të një jete të re i erdhi një ide e mirë, por nuk kishte të ardhura të rregullta dhe mbi të gjitha nuk kishte një garanci. Filloi të punonte në një fabrikë për pak kohë dhe filloi të kryente punë të përkohshme në një kooperativë. Por puna ishte e paktë dhe kontratat ishin gjithmonë prej një apo dy muajsh, dhe nuk i lejonin të vinin mënjatë paratë për një shtëpi. "Doja të nisja një aktivitet të vogël duke shitur në treg, gjerdane, pareo, veshje të importuara nga Kenia dhe kisha nevojë për një hua për të blerë licencën, të hapja Partita Iva dhe të blija një furgon dhe pak mall. Nga disa miq mora vesh risinë e PerMicro, telefonova dhe më lanë takimin e parë", tregon John. Në fakt PerMicro ka nisur veprimtarinë në fund të vitit

2007 dhe sot është operatori i parë italian që jep vetëm mikroredit ose *social lending*, veprimtaria e të cilit frymëzohet nga Grameen Bank e themeluar nga Muhammad Yunus, çmim Nobel për paqen në 2006.

Aktiviteti i tij nuk kufizohet vetëm me dhënien e një huaje por njerëzit që i drejtohen PerMicro, marrin edhe mbështetje dhe konsulentë nga ana e operatorëve që ndjekin sipërmarrësit e vegjël në të gjitha fazat e rrugës së tyre, duke iu ndenjur pranë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së financimit të tyre.

John fillon kështu bisedimet, ideja e tij verifikohet dhe pjesërisht modifikohet, PerMicro e ndihmon edhe në gjetjen e një furgoni më të përshtatshëm dhe bëhen e ribëhen llogaritjet për të vlerësuar më së miri aktivitetin që dëshiron të ndërmarrë.

Pas pak më shumë se dy javësh vjen edhe drita jeshile: John merr huan dhe mund të fillojë aktivitetin.

Sot shkuam ta takonim në tezgën e tij në treg ku na pritni me buzëqeshje, duke na treguar projektet e tij për të ardhmen, dhe për shtëpinë që arriti të marrë me qira.



**për...
të punuar
më vete**



**për...
të çuar
në shkollë
famijët**



**për...
të rritur
aktivitetin
tim**



**për... idenë
time të re**



per... fare!
MICROCREDITO IN ITALIA

Deri më 15.000 euro
për ty, për mundësi të mëdha.

Për të nisur apo për të rritur aktivitetin tënd, për të mbajtur familjen larg, për t'u dhënë një të ardhme fëmijëve të tu:

011 658.778 - info@permicro.it

www.permicro.it



RITMI
Ritorno Montano



INNOVAFINANCE
INTEGRA



Oltre



FAIDEA
Fondazione



UBI Banca

PerMicro është shoqëria e parë italiane e specializuar në dhënien e mikrokredivë në të gjithë territorin kombëtar. Aktiviteti i Per Micro frymëzohet nga ai i Grameen Bank e themeluar nga Muhammad Yunus, çmim Nobel për paqen në vitin 2006.

PerMicro è autorizzata all'esercizio dell'attività finanziaria ai sensi dell'art. 106 - n. di iscr. 41437.

Vetëm dy muaj në qendrat e dëbimit

Hidhet poshtë zgjatja deri në 180 ditë i kohës maksimale të qëndrimit në CIE. Por Lega nuk jepet

Kthehet sërisht në dy muaj koha maksimale e qëndrimit të klandestinëve në qendrat e identifikimit dhe dëbimit, CIE. Pasi mbarojnë 60 ditët, nëse policia nuk ka arritur t'i riadhesojë, sepse është i vështirë identifikimi, apo sepse nuk arrihet një marrëveshje me vendlindjen e klandestinëve, ata duhen lënë të lirë.

Zgjati shumë pak ngritja e kufirit të qëndrimit deri në gjashtë muaj, e sjellë në fuqi nga qeveria me dekret në fund të shkurtit. Kur teksti arriti në Parlament për t'u konvertuar në ligj, kjo normë u hodh poshtë me votat e opozitës dhe të disa deputetëve të mazhorancës, që me sa duket nuk janë dakord me linjën e ashpër të Legës.

"Jam tym" u shpreh i nxehur, menjëherë pas hedhjes poshtë të normës, ministri i Brendshëm Maroni, që kërkon më shumë kohë për identifikimin e personave pa leje qëndrimi në mënyrë që dëbimet të jenë më efikase. Ministri tha se kjo është një "falje për klandestinët" dhe se, me skadimin e dekretit të qeverisë, të paktën njëmijë klandestinë të mbyllur në CIE duhen lënë të lirë me një fletë dëbimi në xhup.

Partia e Bossit dhe e Maronit, premton se nuk do ta lërë me kaq. Ka arritur të marrë premtimin e qeverisë për përvetësimin sa më shpejt të indikacioneve të Bashkimit Europian mbi riadhesimet: parashikon që klandestinët të qëndrojnë në CIE deri në 18 muaj.

Elvio Pasca

PADITJET NË SPITALE TË JASHTËLIGJSHME

Disa emigrantë janë paditur, në Napoli, Brescia, Treviso dhe të tjerë nuk shkojnë në spitale prej frikës së dëbimit. Por propozimi i Legës nuk është akoma ligj dhe ndoshta nuk do të jetë kurrë.



Propozimi i Legës mbi sinjalizimin e klandestinëve që shkojnë në repartin e ndihmës së shpejtë, ka nisur të bëjë dëm. Edhe pse nuk ka asnjë vlerë ligjore, ka shtyrë disa operatorë në spitale të aplikojnë kërkesën e Legës dhe ka frenuar shumë emigrantë që kanë nevojë për ndihmë mjekësore. Por një marrëveshje mes PdL-s dhe Legës lë të kuptohet që kjo normë do të hiqet nga projekti i ligjit për sigurinë.

Në mars Kante, një grua ivoriane, u denoncau pasi lindi në spitalin Fattebenefratelli të Napolit. Më pas, e mbrojtur nga një avokat, gruaja mori lejen e qëndrimit që i takon me ligj. Pas disa ditëve, në Brescia, në një situatë të ngjashme u gjend Macan, një i ri senegalez mori fletën e dëbimit për shkak të dhimbjes së dhëmbëve. "Nuk e di kush më denoncoi - tregoi - fakt është që më dhanë dëbimin dhe nuk do të shkel kurrë më në një

spital italian". E ndodhi sërisht në prill. Në Treviso një mjek i repartit të ndihmës së shpejtë paditi pacienten nigeriane.

I shkoi më keq akoma bolivianit që u paraqit në spitalin San Matteo të Pavis pas dhjetë ditëve me dhimbje barku, që mundahej të lehtësonte duke u bërë mjek i vetes. Edhe ai klandestin, kish frikë mos denoncohej dhe kjo frikë i kushtoi shëndetin. Kishte apendicit dhe meqë nuk u operua në kohë iu transformua në peritonit. Pas shumë ndërhyrjesh kirurgjikale, përfundoi në rianimacion.

"Nëse raste si ky i bolivianit shtohen, do të krijohet një situatë shumë e rëndë", thotë Aldo Morrone, drejtor i përgjithshëm i Institutit kombëtar për promovimin e shëndetit të migrantëve dhe kontrastin e sëmundjeve të varfërisë (Inmp). Morrone kujton që aktualisht në

Itali është në fuqi ligji që ndalon personelin e strukturave spitalore të padisin klandestinët që u drejtohen për kura mjekësore: "U drejtohem emigrantëve duke u thënë 'drejtoju pa frikë spitalëve nëse keni nevojë, nuk rrezikoni asgjë sepse ligji në fuqi ju mbrohet'".

Në fakt "përfitimimi nga strukturat shëndetësore nga anë e të huajt pa qëndrim të rregullt nuk mund të sjellë asnjë lloj sinjalizimi pranë autoriteteve, me përjashtim të rasteve kur lajmërimi i forcave të rendit është i detyruar me ligj, njësoj si për shtetasin italian" (paragrafi 5, neni 35 i dekretit legjislativ 286/98). Kjo normë është në fuqi në Itali prej vitit 1995, me dekretligj (DL 489/95 neni 13) i miratuar nga qendra e djathtë, përfshirë edhe votat e Legës. Ndoshta sepse "logjika" e normës nuk është vetëm ajo e "dhënies së ndihmës/kurës emigrantit të parregullt", por edhe mbrojtja e mbarë komunitetit. Sot, kundër propozimit të Legës proteston e gjithë opozita dhe një pjesë e mazhorancës. Me një letër, njëqind parlamentarë të PdL-s i kanë kërkuar Berlusconi të mos i japë besimin normës që shkel "të drejtat themelore të njeriut". Të shumtë zërat kundër edhe mes mjekëve. Kështu, Shoqëria italiane e shëndetësisë së migracioneve pohon: "Të parashikosh denoncimin menjëherë pas dhënies së ndihmës mjekësore do të ngrinte një barrierë të pakalueshme dhe do të shtynte drejt "klandestinitetit shëndetësor" të rrezikshëm për individin e komunitetin".

Antonia Ilinova

Ende probleme për përtëritjen e lejeqëndrimeve. Në fillim të prillit, softueri që shërben për plotësimin e kërkesave për lejeqëndrim i përdorur nga sportelet e komunave dhe të patronateve, filloi përsëri të çalojë, duke zgjatur kështu kohën e pritjes për mijëra shtetas të huaj që kërkonin përtëritjen e dokumentit të tyre.

Nëpër sportele problemi ishte i prekshëm. "Ka disa ditë që për të plotësuar kërkesat, na duhet dyfishi i kohës" pohon Enrico Dini, nga patronati Inca në sheshin Vittorio në Romë, që përshkruan dy tipe prob-

Lejet e qëndrimit, probleme e vonesa

Problem me softuerin e plotësimit të kërkesave kërkesave
Pritje të gjata në sportelet e patronateve dhe komunave

lemesh: "Pikësëpari ngadalësia e kalimit nga njëra faqe në tjetrën për të plotësuar kërkesat. Pastaj ngandonjëherë kur duhet të shtypësh një dokument, bllokohet gjithçka".

Si mund të bësh pa shtypur dokumentet? Është e domosdoshme për të paraqitur kërkesën pranë zyrës postale. "Nëse bllokohet, e shtypim në

një çast tjetër - sqaron Dini - edhe të nesërmen. Dhe për fat të keq në të tilla raste i interesuari duhet të kthehet përsëri në sportelin tonë".

Pas disa ditësh sistemi i drejtuar nga Postat Italiane për llogari të ministrisë së Brendshme, u vu përsëri në punë. Por tani patronatet kanë frikë se mund të bllokohet sërisht, edhe

sepse probleme të këtij lloji përsëriten prej tre muajsh: "Koha e përpunimit është shumë e ngadaltë dhe ka pezullime të papritura të hyrjes në portal që shpesh kanë penguar zhvillimin e procedurave" denoncojnë në një komunikatë Acli, Inas Cisl, Inca Cgil, Ital Uil.

Ata që e pësojnë janë gjithmonë shtetasit e huaj. "Këto probleme - shkruajnë patronatet - pengojnë shumë njerëz në plotësimin e praktikave në kohë të arsyeshme, duke sjellë probleme të mëdha në të gjitha aspektet e jetës së tyre, që nga pozita në punë deri në atë në shoqëri".

www.aloartdance.com
aloart
Dance

Il vestitario pensato
per le scuole di danza

aloart
Dance

Mobile +39 334 7621125
Fax +39 02 700 438 165
e-mail: info@aloartdance.com

www.aloartdance.com

la qualità aloart
al prezzo giusto...



Presenti in DANZA in FIERA
Padiglione Spadolini - Piano Attico Stand O1



Comune
di Fermo



Comune
di Porto San Giorgio



ACADEMY

GISELLE

DANZA E MUSICA



JOE ARTID FEJZO • GISELLE DANZA E MUSICA

Firmum Dance Festival

Villa Vitali - Fermo - Italy

5-12 Luglio 2009

Porto S. Giorgio in Danza

Workshops - Porto San Giorgio (FM) - Italy

www.crystalofdance.com

PORTO SAN GIORGIO
Filiale di MONTEGRANARO
Tel. 0734.672051 - 328.6136499

info@giselle.it
www.giselle.it

Një sanatore emigrantësh për rimëkëmbjen e Abruzzo-s

Dhënia e një lejeje atyre që kanë punë do të sillte disa miliardë euro në arkat e shtetit. Propozimi i Stranieriinitalia.it

Sanatoria e punëtorëve imigrantë mund të paguajë rindërtimin në Abruzzo. Është ky propozimi që bën Stranieriinitalia.it, portali i imigracionit.

Në Itali ka të paktën 600 mijë shtetas të huaj pa lejeqëndrim që punojnë patjetër në të zezë pranë ndërmarrjeve apo familjeve. Janë njerëz të ndershëm, të cilët nuk kanë arritur të kalojnë përmes hallkave të ngushta të ligjit të emigracionit dhe kërkojnë vetëm mundësinë për të jetuar më së fundi nën dritën e diellit. Kjo mundësi mund t'u ofrohej, siç ndodhi me sanatore në të kaluarën në shkëmbim të një kontributi aforfë. Ishte 700 euro për person, shuma e kërkuar në 2002, që do të sillte në arkat e shtetit 420 milionë euro, një burim i rëndësishëm, i disponueshëm menjëherë që do të shërbente për të përballuar emergjencën e tërmetit. Dhe nëse ky kontribut do të ishte vetëm për një herë të vetme, thesari i vërtetë do të

Kuota të reja për të përjashtuarit nga dekretet e flukseve

Projektligji i deputetes së PdL-s, Sbai: "Duhet një zgjidhje për t'u dhënë dokumentet atyre që janë në Itali"

"Me rastin e dekretit të flukseve të përvitshme, nevojitet të caktohet një kuota për punëtorët e huaj për të cilët kërkesa për autorizim pune është paraqitur prej tre vjetësh dhe që kanë mbetur jashtë, sepse më të shumtë në numër se sa kuota e parashikuar".

Kjo është çka parashikon propozimi i ligjit në çështje të imigracionit dhe të përcaktimit të flukseve të hyrjes paraqitur pranë Dhomës nga deputetja e PdL-s, Souad Sbai.

"Në vendin tonë - sqaron Sbai - duhet vlerësuar prania e madhe e imigrantëve, të detyruar të jenë të parregullt, por që prej kohësh janë në varësi të punëdhënësve, të cilët kanë kërkuar për ta autorizimin për punë që me dekretin e flukseve të vitit 2007".

"Janë të njëjtat të dhëna që jepen

nga ministria e brendshme dhe që përforcohen nga dekreti i fundit i flukseve i nxjerrë në dhjetor, - ripohon deputetja e PdL-së - që vënë në dukje teprica të kërkesave dhe nevojën e pamohueshme për një zgjidhje të çështjes së dhënies së dokumenteve të qëndrimit të huajve të parregullt që gjenden në territorin italian, duke qenë se dekretet me kalimin e kohës i mbivendosen njëri-tjetrit dhe tepricat e kërkesave shtohen gjithmonë e më tepër".

Sbai kërkon kështu caktimin e kuotave rezervë, siç ndodh për punëtorët me origjinë italiane, për veteranët e flukseve, pra për "punëtorët e huaj për të cilët është paraqitur kërkesë prej tre vjetësh, dhe që kanë paraqitur dokumentacion të rregullt" por që deri tani nuk kanë arritur të përfitojnë në kuota.

vinte nga derdhja e vazhdueshme fiskale nga ana e 600 mijë punëtorëve që këtej e tutje do të punonin me kontratë të rregullt pune. Sipas disa vlerësimeve të fundit të të përditshmes Il Sole 24 Ore, ata do të derdhnin më shumë se 730 milionë taksa dhe mëse 2,4 miliardë në vit kontribute, një pjesë e të cilave mund të destinohet në mënyrë të jashtëzakonshme për rindërtimin.

"Sanatoria do të ishte kështu e vetmja rrugë e mundshme për të nxjerrë nga hija qindra mijëra njerëz, por në të njëjtën kohë do të shndërrohej edhe në një rast të mirë për të përforcuar solidaritetin ndërmjet këtyre qytetarëve të rinj dhe italianëve. Ndoshta do të ishte një shmangie nga linja e ndërmarrë nga qeveria lidhur me emigrantët, por do të justifikonte një qëllim më të rëndësishëm" komenton Gianluca Luciano, administratori i Stranieri in Italia.

Elvio Pasca

MË I LEHTË KONVERTIMI I LEJEQËNDRIMIT TË STUDENTËVE

Me master, doktoratë apo specializim, lejeqëndrim për punë pa kaluar përmes flukseve

Edhe një titull pasuniversitar i kryer në Itali u jep të drejtë studentëve të huaj që kanë gjetur punë të marrin një lejeqëndrim për motive pune pavarësisht nga dekreti i flukseve. Mund të kërkojnë konvertimin e lejeqëndrimit të tyre në çdo kohë të vitit, pa u shqetësuar për kuota.

Deri tani studentët e huaj që merrnin një diplomë në Itali, së bashku me ata që moshën madhore i gjente me qëndrim të rregullt në Itali, mund të konvertonin lejeqëndrimin e tyre nga "për motive studimi" në "për motive pune", jashtë dekretive të flukseve. Të tjerët duhet të paraqitnin kërkesë pas botimit të dekretit (që çdo vit parashikon disa kuota për konvertimet), dhe të armatoseshin me durim e të shpresonin për fat të mirë.

Në mars, ministria e brendshme, komunikoi nëpërmjet një qarkoreje, se lista është zgjeruar duke përfshirë edhe të tjerë tituj që japin të drejtën e konvertimit:

- Diplomim (3 vjet, 180 kredite)

- Diplomë specializimi/magjistrale (300 kredite, 180 kredite të diplomës dhe 120 kredite të diplomës magjistrale)

- Diplomë specializimi (të paktën dy vjet)

- Doktoratë (të paktën 3 vjet)

- Master universitar i nivelit I (të paktën 1 vit - 60 kredite) ku hyhet me një diplomë

- Master universitar i nivelit II (të paktën 60 kredite) ku hyhet me diploma të trevjeçarit, diplomë specializimi, diplomë magjistrale.

ZBRITJE NGA TAKSAT PËR PUNËDHËNËSIT E BASHKËPUNËTOREVE FAMILJARË

Mund të zbresin nga të ardhurat kontributet e sigurimeve shoqërore, më tepër nëse bashkëpunëtorja asistoi të sëmurë

Ndërsa deklarimi i të ardhurave po troket, ata që ndihmohen nga ndonjë bashkëpunëtorë shtëpiake me kontratë të rregullt, do të bënin mirë të mbanin menjëherë buletinet e derdhjeve të kontributeve dhe prospektet e pagesës për vitin e kaluar. Do të shërbejnë për të kursyer në taksa. Një lehtësim i parë fiskal që preket të gjithë punëdhënësit e bashkëpunëtorëve shtëpiakë, është zbritja nga të ardhurat e tatueshme, pra ato mbi të cilat llogariten taksa që duhen paguar, kontributet INPS të derdhura për bashkëpunëtorët shtëpiakë, deri në një maksimum prej 1.549,37 eurosh. Derdhjet mund të dokumentohen me buletinet e derdhjeve të kontributeve.

Një tjetër kursim parashikohet nëse bashkëpunëtorja shtëpiake (badante) asiston një njeri jo të vetëmjaftueshëm, pra që sipas certifikatës mjekësore nuk mund

të ushqehet vetë, të kryejë funksionet fiziologjike, të lahet, të ecë, të vishet apo ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm. Në të tilla raste përfitohet e drejta për një ulje nga taksat sa 19% e shpenzimeve të kryera për bashkëpunëtorin shtëpiakë, deri në një maksimum prej 2.100 eurosh, por vetëm nëse të ardhurat e taksapaguesit nuk i kalojnë të 40 mijë eurot.

Ka të drejtë për këtë ulje, kushdo që paguan një punëtorin shtëpiakë, qoftë personi jo i vetëmjaftueshëm, qoftë një familjar i tij. Me deklarimin e të ardhurave duhet të paraqiten buletinet, prospektet e pagave apo dokumente të tjera që vërtetojnë pagesën, mbi të cilat duhet të jetë kodi fiskal dhe të dhënat personale të bashkëpunëtores shtëpiake, të atij që e paguan, dhe nëse nuk është i njëjti person edhe të të moshuarit apo të të sëmurit të asistuar.



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

Tregoni historinë tuaj



Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek

www.migrart.it



Comune di Milano



contrasto



IGPDecaux
comunicazione esterna





www.stranieriinitalia.it

Faqet internet të emigracionit